

# Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë

(Zgjedhjet Parlamentare 2025:  
Analizë e listave të kandidatëve dhe  
programeve politike)





# **Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë**

**(Zgjedhjet Parlamentare 2025:  
Analizë e listave të kandidatëve dhe  
programeve politike)**

TITULLI:

**Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë  
(Zgjedhjet Parlamentare 2025: Analizë e listave të kandidatëve dhe  
programeve politike)**

AUTOR:

Koalicioni i organizatave (FOL, IKD dhe INPO)

VITI I BOTIMIT:

2025

\* Ky publikim është financuar nga Rockefeller Brothers Fund. Përmbajtja e tij si dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Rockefeller Brothers Fund.

**Të drejtat e autorit © 2025.** Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues ose ndryshe, pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit.

# Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	7
2. Metodologjia	9
3. Zgjedhjet e vitit 2025	10
4. Programet politike	12
5. Pastërtia e listave zgjedhore	20
5.1. Kandidatët me aktakuza aktive	21
5.2. Kandidatët me dënime	23
6. Sundimi i ligjit në programet politike	25
6.1. Lëvizja Vetëvendosje	25
6.2. Lidhja Demokratike e Kosovës	26
6.3. Partia Demokratike e Kosovës	28
6.4. Koalicioni AAK – Nisma	29
6.5. Drejtësia në programet tjera	30
7. Qeverisja e mirë dhe të drejtat e njeriut në programet politike	31
7.1. Lëvizja VETËVENDOSJE	31
7.2. Partia Demokratike e Kosovës	32
7.3. Lidhja Demokratike e Kosovës	34
7.4. Koalicioni AAK-Nisma	35
7.5. Koalicioni për Familje	37
7.6. Partia Liberale Egjiptiane	37
7.7. PDAK-LPB	38
7.8. Demokracia Serbe	38
7.9. Iniciative e Re Demokratike e Kosovës	39
7.10. Koalicioni ynë Boshnjak	40
7.11. Fjala	41
7.12. Partia e Bashkuar e Goranëve	41
7.13. Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë	42



# 1. Përmbledhje ekzekutive

Që nga shpallja e pavarësisë më 2008, Kosova ka mbajtur pesë zgjedhje të përgjithshme, por asnjëherë në afatin e rregullt për shkak të prishjes së koalicioneve dhe shpërbërjes së Kuvendit. Për herë të parë nga shpallja e pavarësisë, me 9 shkurtit 2025 Kosova do të zhvilloj zgjedhje të rregullta parlamentare. Këto zgjedhje do të zhvillohen sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili hyri në fuqi në korrik 2023 pas një konsensusi të partive politike. Për këto zgjedhje, janë certifikuar 28 subjekte politike me gjithsej 1280 kandidatë, përfshirë parti politike, koalicione, nisma qytetare dhe një kandidat të pavarur. Nga 28 subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e 2025-ës, për vetëm 13 sosh është i qashtëm programi i tyre për këto zgjedhje.

Raporti paraqet analiza dhe gjetje rreth kandidatëve të certifikuar për zgjedhje, të cilët kanë probleme me ligjin. Po ashtu, raporti përfshinë analizën kualitative mbi përmbajtjen e programeve politike të subjekteve të certifikuara politike, duke u përqendruar në aspektet e sundimit të ligjit, qeverisjes së mirë dhe të drejtave të njeriut. Sa i përket listave të kandidatëve, të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptimin e aktakuzave aktive dhe dënimeve, tre subjekte politike: 1) Lëvizja Vetëvendosje; 2) koalicioni AAK-Nisma; dhe 3) Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë përfshirë në listat e tyre gjithsej 23 kandidatë që kanë probleme me ligjin, që përbëjnë rreth 7% të totalit të kandidatëve të tyre. Lëvizja Vetëvendosje ka numrin më të madh me 14 kandidatë (12.72% e listës), ndërsa koalicioni AAK-Nisma ka përfshirë tetë kandidatë (7.27%), dhe LDK një kandidat.

Nga 23 kandidatët për deputetë me probleme ligjore, 16 prej tyre përballen me aktakuza aktive, ndërsa tetë kanë dënime të formës së prerë. Në total, ndaj këtyre kandidatëve janë ngritur 20 aktakuza për 21 vepra penale, që përfshijnë veprat penale të korrupsion si "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar", ashtu edhe vepra të tjera penale, si përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm (nëntë raste), mbajtja e paautorizuar e armëve (pesë raste), pengimi apo sulmi ndaj personave zyrtarë dhe vepra të tjera të natyrës kriminale.

Plan-programet e partive politike për drejtësinë në zgjedhjet e 2025-ës paraqesin dallime të mëdha në qasjen dhe seriozitetin e tyre. Lëvizja Vetëvendosje e trajton drejtësinë vetëm në një faqe të programit të saj dhe nuk i referohet fare Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Ajo propozon krijimin e një Gjykate për çështje familjare, një Prokurorie të Specializuar dhe një Zyre për Hetime Disiplinore, por pa ndonjë analizë të thelluar mbi nevojën dhe funksionalitetin e tyre. Mungesa e një plani të detajuar dhe dublikimi i mekanizmave ekzistues e bën këtë program të konsiderohet joserioz.

Lidhja Demokratike e Kosovës e trajton drejtësinë më gjerësisht, duke përfshirë vetingun, integritetin e sistemit të drejtësisë, rikthimin e pavarësisë së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas dhe digjitalizimin e shërbimeve. Megjithatë, programi i saj nuk mbështetet në analiza të detajuara dhe nuk i referohet Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Gjithashtu, disa propozime, si fuqizimi i kriterëve për provimin e jurisprudencës dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve, mbeten të paqarta dhe pa argumentim të mjaftueshëm.

Partia Demokratike e Kosovës ka përfshirë 14 pika në kapitullin e saj për drejtësinë, duke theksuar strategjitë kundër korrupsionit dhe reformën e sistemit gjyqësor. As ky program nuk e përmendin fare Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Programi në fjalë propozon krijimin e Byrosë Kombëtare të Hetimeve, por ky institucion paraqet një dublim të kompetencave të Prokurorisë Speciale dhe mund të krijojë mbikëqyrje të tepërt mbi sistemin gjyqësor. Programi gjithashtu parashikon miratimin e një Strategjie Kombëtare për Krimet e Luftës dhe krijimin e një Gjykate të Punës, por pa argumentim të qartë për nevojën e një institucioni të tillë.

Koalicioni AAK-Nisma e vendos sundimin e ligjit si prioritet kryesor, por nuk ofron propozime konkrete për zbatimin e tij. Programi i Koalicionit për Familjen përmban 15 pika mbi drejtësinë, por pa elaborime mbi implementimin e tyre, ndërsa disa parti të tjera, si Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës dhe Partia Fjala, trajtojnë sundimin e ligjit në mënyrë shumë të përgjithshme dhe pa masa konkrete.

Programet elektorale të partive kryesore për zgjedhjet e 2025-ës adresojnë çështje si transparenca, qeverisja e mirë, administrata publike, barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut, por shumica prej tyre nuk ofrojnë detaje të qarta mbi mekanizmat e zbatimit dhe burimet financiare të reformave të propozuara. PDK dhe LDK e theksojnë transparençën dhe digjitalizimin, por nuk japin sqarime mbi mënyrën e realizimit të këtyre reformave. AAK premtion zhvillim ekonomik dhe rritje pagash në administratën publike, por pa plan të qartë për mbështetje buxhetore. Koalicioni për Familjen dhe partitë më të vogla, si Partia Liberale Egjiptiane dhe PDAK-LPB, përmendin temat e sundimit të ligjit dhe barazisë, por programet e tyre mbeten të përgjithshme dhe pa strategji të mirë përcaktuara për implementim.

Lëvizja Vetëvendosje fokusohet kryesisht në projekte infrastrukturore, duke mos përfshirë në program tema kyçe si administrata publike, transparenca dhe llogaridhënia. Reformimi i sistemit të administratës, që ka qenë një nga çështjet më të debatuar gjatë mandatit të kaluar, nuk trajtohet në programin e saj elektorale, ndërsa moszbatimi i Aktgjykimit për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, nuk përmendet askund.

Në përgjithësi, shumica e programeve elektorale nuk japin masa konkrete për të siguruar administratë publike të depolitizuar dhe efikase. Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut përmenden në mënyrë të përgjithshme, por pa masa të qarta për adresimin e tyre në praktikë. Po ashtu, ndërsa disa programe flasin për luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e institucioneve të pavarura, mungojnë detaje mbi mekanizmat konkretë për të siguruar llogaridhënien dhe qeverisjen e pastër. Kështu, pjesa më e madhe e premtimeve elektorale mbeten të përgjithshme dhe pa një strategji të mirë përcaktuar për implementim efektiv.



## 2. Metodologjia

Me qëllim të pasqyrim të kandidatëve të certifikuar të cilët kanë probleme me ligjin dhe analizës së programeve zgjedhore në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, Koalicioni i OJQ-ve , IKD, FOL dhe INPO (tutje: koalicioni), ka aplikuar një metodologji të adaptuar për qëllime të këtij raporti.

Ky raport është përpiluar pas një analizimi të programeve të subjekteve politike, për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Po ashtu, pjesë e analizimit kanë qenë edhe listat e kandidatëve për deputetë të këtyre subjekteve.

Sa i përket programeve për këto zgjedhje, ato janë mbledhur përmes web-faqeve, apo faqeve zyrtareve në rrjetet sociale të subjekteve politike të licencuara për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Përderisa, në rastet kur ky program nuk është gjetur i publikuar nga subjektet politike, koalicioni ka dërguar email zyrtar tek të njëjtat, përmes të cilit është kërkuar programi i tyre<sup>1</sup>. Kjo me qëllimin që të analizohen programet e të gjitha subjekteve të certifikuara politike për zgjedhjet të përgjithshme të vitit 2025. Andaj, subjektet për të cilat nuk është arritur të gjetet programi, apo nuk i janë përgjigjur kërkesës, koalicioni ka konsideruar se të njëjtat nuk kanë program për këto zgjedhje.

Ndërkaq, sa i përket analizimit të këtyre programeve, në një kapitull të veçantë është bërë një analizim i përgjithshëm dhe një përshkrim i shkurtër i programeve, ku kryesisht janë përmendur vetëm fushat ose kryetitujt për të cilat janë dhënë zotime, janë paraqitur synime, apo janë përshkruar edhe masa apo veprime. Kurse, fokus i këtij analizimi kanë qenë dy fusha: Sundimi i ligjit dhe Qeverisja e mirë dhe të drejtat e njeriut. Për të dyja këto është bërë një analizim i detajuar kualitativ derisa gjetjet janë paraqitur në kapituj të veçantë.

Ndërsa, në lidhje me listat e kandidatëve të të gjitha subjekteve politike të certifikuara për këto zgjedhje, të njëjtat janë analizuar lidhur me atë se cilët kandidatë kanë probleme me ligjin. Në këtë rast, kur themi probleme me ligjin, nënkuptohet për personat të cilët kanë qenë të dënuar për vepra penale apo kanë aktakuza aktive. Gjetjet përkitazi me kandidatët e certifikuar të cilët kanë probleme me ligjin janë nxjerrë nga databaza e monitorimit të IKD. Potencialisht, mund të ketë edhe kandidatë të tjerë të cilët kanë probleme me ligjin, por se nuk kanë qenë të evidentuar në këtë databazë.

Krejt në fund, gjetjet e këtij raporti, para publikimit të tij, janë ndarë edhe me subjektet e certifikuara politike. Asnjë prej tyre nuk kanë dërguar komente.

---

<sup>1</sup> Shënim: Kandidati i pavarur Fatmir Bytyqi nuk është kontaktuar. Për të njëjtin nuk është gjetur programi politik dhe as email-i kontaktues në listën e kontakteve të publikuar nga KQZ.

### 3. Zgjedhjet e vitit 2025

Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2008, janë mbajtur pesë zgjedhje të përgjithshme. Megjithatë, për shkak të pamundësisë për të përfunduar mandatin katërvjeçar, asnjë prej këtyre zgjedhjeve nuk ka mundur të zhvillohet në mënyrë të rregullt.

Andaj, zgjedhjet që janë caktuar të mbahen me 9 shkurt 2025, do jenë zgjedhjet e përgjithshme të rregullta për herë të parë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Këto zgjedhje do të zhvillohen sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2023, pas një konsensusi të gjerë të partive politike në Kuvendin e Kosovës.

Për zgjedhjet e 9 shkurt 2025, periudha për të aplikuar për certifikim, kishte qenë e hapur nga 1 shtator 2024, e deri më 11 dhjetor 2024. Gjatë kësaj kohe, në KQZ kishin aplikuar 28 subjekte politike. Përderisa, këto subjekte politike përfaqësoheshin nga total 1280 kandidatë. Prej këtyre subjekteve politike, 20 ishin parti politike, pesë koalicione, dy nisma qytetare dhe një kandidatë i pavarur<sup>2</sup>.

Për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, periudha për aplikimin për certifikim ka qenë e hapur nga 1 shtatori 2024 deri më 11 dhjetor 2024. Gjatë kësaj periudhe, në KQZ janë regjistruar 28 subjekte politike, të cilat përfaqësoheshin nga gjithsej 1,280 kandidatë. Prej këtyre subjekteve, 20 ishin parti politike, pesë koalicione, dy nisma qytetare dhe një kandidat i pavarur.

Për certifikim të subjekteve politike për pjesëmarrje në këto zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte vendosur gjatë dy mbledhjeve të ndryshme. Në mbledhjen e mbajtur me 18 dhjetor 2024, KQZ kishte certifikuar 11 subjekte politike, të cilat përfaqësoheshin nga gjithsej 606 kandidatë. Ndërkaq, më 31 dhjetor 2024, kishte certifikuar edhe 17 subjekte politike, përfaqësuar nga 674 kandidatë. Kështu, për këto zgjedhje, janë certifikuar në total 28 subjekte politike me gjithsej 1,280 kandidatë<sup>3</sup>. Mirëpo, përgjatë këtij procesi të certifikimit, problematike doli të jetë mos certifikimi i Listës Serbe më 23 dhjetor 2024. Kundërshtimi për certifikimi i Listës Serbe kishte ardhur nga përfaqësuesit e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në KQZ, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi. Përkundër që Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike kishte rekomanduar certifikimin e këtij subjekti politik, me 23 dhjetor 2024, KQZ nuk e kishte certifikuar. Ky veprim i KQZ bëri bujë të madhe në publik, për shkak se edhe ky subjekt politik veçse kishte kaluar procesin e verifikimit nga KGJK, MPB, MPJD e PZAP<sup>45</sup>.

2 "Përmbillet afati, 28 subjekte politike me 1,280 kandidatë aplikojnë për certifikim për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 12 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kqz-ks.org/permbyllet-afati-28-subjekte-politike-me-1280-kandidate-aplikojne-per-certifikim-per-pjesemarrje-ne-zgjedhjet-per-kuvendin-e-kosoves/>).

3 "KQZ përmbyllë certifikimin e 28 subjekteve politike dhe 1,280 kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 31 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kqz-ks.org/kqz-permbylle-certifikimin-e-28-subjekteve-politike-dhe-1280-kandidateve-per-pjesemarrje-ne-zgjedhjet-per-kuvendin-e-kosoves/>).

4 "Moscertifikimi nga KQZ- Lista Serbe ka 48 orë kohë të ankohet në PZAP, nëse rrezohet rasti shkon në Supreme". Gazeta Express. 24 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/moscertifikimi-nga-kqz-lista-serbe-ka-48-ore-kohe-te-ankohet-ne-pzap-nese-rrezohet-rasti-shkon-ne-supreme/>).

5 "Beteja ligjore mes LVV-së dhe Listës Serbe". Radio Evropa e Lirë. 3 janar 2025. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/beteja-ligjore-mes-lvv-dhe-liste-serbe/33262459.html>).

Lidhur me mos certifikimin e Listës Serbe, shqetësim dhe keqardhje kishin shprehur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian dhe Gjermania<sup>6</sup>.

Mirëpo, PZAP, më 25 dhjetor 2024, mori vendim që të anulojë vendimin e KQZ-së dhe ta urdhërojë atë për të certifikuar Listën Serbe me 48 kandidatët e saj<sup>7</sup>. Në këtë vendim të PZAP, mes tjerash thuhej se në rastin konkret, ky subjekt, ka dorëzuar aplikimin e kompletuar në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ndërsa, theksonte se KQZ është e obliguar që të të certifikojë çdo subjekt politik i cili i plotëson kushtet e parapara ligjore.<sup>8</sup>

Më tej, LVV kishte bërë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila e kishte hedhur poshtë ankesën e LVV si të palejuar<sup>9</sup>.

Kështu, KQZ e certifikoi Listën Serbe në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2024. Ndërsa, Ambasada Amerikane e kishte mirëpritur vendim, përdërisa kishte theksuar se të gjitha partitë dhe kandidatët duhet të refuzojnë çdo përpjekje për politizimin e procesit zgjedhor<sup>10</sup>.

---

6 "Perëndimi shpreh shqetësim për moscertifikimin e Listës Serbe". Radio Evropa e Lirë. 23 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/shba-thellessisht-e-shqetuar-nga-moscertifikimi-i-listes-serbe/33250482.html>).

7 "KQZ përmbyllë certifikimin e 28 subjekteve politike dhe 1,280 kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 31 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kqz-ks.org/kqz-permbylle-certifikimin-e-28-subjekteve-politike-dhe-1280-kandidateve-per-pjesemarrje-ne-zgjedhjet-per-kuvendin-e-kosoves/>).

8 "PZAP-i urdhëron KQZ-në që ta certifikojë Listën Serbe për zgjedhje". Radio Evropa e Lirë. 25 dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/pzap-certifikim-lista-serbe/33252812.html>).

9 "Supremja e hedh poshtë ankesën e LVV-së kundër urdhrin të PZAP-it për certifikimin e Listës Serbe". Radio Evropa e Lirë. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/supremja-hedh-poshte-ankese-vv-lista-serbe/33259196.html>).

10 Faqja zyrtare e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, në rrjetin social "X". (Shih linkun: <https://x.com/USEmbPristina/status/1874120365477122184>).

## 4. Programet politike

Përmes programeve politike, subjektet ose partitë politike paraqesin vizionin rreth qeverisjes së tyre. Përgjithësisht, këto programe politike shpalosen para elektoratit me fillimin e fushatës zgjedhore. Kështu, publikut i mundësohet që të shoh se çfarë politikash do ndjekin dhe për çfarë qëndrojnë subjektet politike përgjatë qeverisjes së tyre dhe se cilat janë do jenë prioritetet e tyre.

Mirëpo, sado të rëndësishme që konsiderohet të jenë, jo të gjitha subjektet politike ua ofrojnë elektoratit një dokument të tillë.

Nga 28 subjekte politike të certifikuara, koalicioni ka arritur të sigurojë programet e vetëm 13 prej tyre, për zgjedhjet 2025. Më poshtë gjeni tabelat ku paraqiten subjektet politike të cilat kanë program për këto zgjedhje, e cilat nuk kanë paraqitur një të tillë.

**Nr Subjektet politike me program**

- 1 Lëvizja VETËVENDOSJE

---

- 2 Partia Demokratike e Kosovës – PDK

---

- 3 Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

---

- 4 IRDK – Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës

---

- 5 Jedinstvena Goranska Partija

---

- 6 Za Slobodu Pravdu i Opstanak

---

- 7 AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma – Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi intelektual – E – 30

---

- 8 FJALA

---

- 9 PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE – PLE

---

- 10 SRPSKA DEMOKRATIJA

---

- 11 Koalicioni për Familje

---

- 12 PDAK – LPB

---

- 13 Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka)

---


**Nr Subjektet politike pa program**

- 1 Kosova Demokratik Turk Partisi

---

- 2 Koalicija Vakati

---

- 3 PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

---

- 4 NOVA DEMOKRATSKA STRANKA

---

- 5 PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS

---

- 6 Yenilikçi Türk Hareket Partisi

---

- 7 GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA

---

- 8 Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar

---

- 9 Kosova Adalet Türk Partisi

---

- 10 Opre Roma Kosova

---

- 11 FATMIR BYTYQI

---

- 12 SRPSKA LISTA

---

- 13 Srpski narodni pokret

---

- 14 Partija kosovskih Srba

---

- 15 SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA – SDU

---


**TABELA 1** Subjektet politike me program (majtas) dhe ato pa program.

## ► Lëvizja Vetëvendosje

Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur një program prej 63 faqesh. Sa i përket zotimeve dhe programeve të tyre, ky dokument është i ndarë në 25 kapituj.

Prej këtyre kapitujve, 13 prej tyre përmbajnë pika apo nënkapituj të veçantë, në total 34 sosh. Të tillë janë kapitujt që flasin për: drejtësinë; infrastrukturën; energjinë dhe minierat; ujërat; shëndetin; shkollimin; studentët; punëtorët; gratë; fëmijët; transportin publik; inovacionin dhe teknologjinë; dhe prodhimtarinë/ndërmarrësinë.

Përderisa 12 kapituj nuk përmbajnë pika ose nënkapituj të veçantë. Këta janë kapitujt që flasin për: financat publike; Brezovicën; mërgatën; bujqësinë; projektet kapitale; komunitat; sportin; artin; trashëgiminë kulturore; sigurinë; mbrojtjen, si dhe politikën e jashtme dhe integrimet evropiane.

## ► Partia Demokratike e Kosovës

Në një program prej 62 faqesh të këtij subjekti politik thuhet se plani i tyre zhvillimor ndërtohet rreth pesë qëllimeve kyçe. Këto pesë qëllime kyçe që paraqiten në këtë program janë: 1) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; 2) Jetë më e mirë për secilin; 3) Arsim për të ardhmen; 4) Sistem shëndetësor me pacientin në qendër; 5) Një Kosovë e sigurt dhe e integruar.

Në këtë program janë paraqitur në total 212 veprime të propozuara për të gjitha fushat që përfshihen në të. Konkretisht këto veprime propozohen për zhvillimin ekonomik, tregun e punës, për çështje familjare, energjinë elektrike, sektorin minerar, bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, reformim të drejtësisë, administratë publike, çështje të sigurisë, art dhe kulturë, turizëm dhe sport. Po ashtu, veprime janë paraqitur edhe për politikën e jashtme, e cila në këtë program ndahet në nënpika për diplomaci, integrim evropian, mërgatë, integrim mbarëkombëtarë, dhe normalizim i marrëdhënieve me Serbinë.

## ► Lidhja Demokratike e Kosovës

Lidhja Demokratike e Kosovës ka shpалosur një program prej 248 faqesh. Përmes një kapitulli që flet për programin qeverisës, LDK ka theksuar 22 pika.

Këto pika kanë të bëjnë me ekonominë dhe financat, energjinë, digjitalizimin dhe teknologjinë informative. Tutje, në këto pika përfshijnë edhe infrastrukturën, familjen dhe mirëqenien, shëndetësinë, arsimin, mbrojtjen, rendin dhe sigurinë, drejtësinë, e integrimet euroatlantike.

Më tej, përfshihen edhe pika që kanë të bëjnë me politikën e jashtme, sportin, planifikimin hapësinor dhe mjedisin, bujqësinë, kulturën, administratën publike, qeverisjen lokale, mërgatën, tregtinë dhe industrinë, politikën sociale dhe pensionale, si dhe sektorin financiar.

Ndërkaq, në secilën prej këtyre pikave LDK ka paraqitur edhe synimet që ka për secilën prej këtyre fushave. Konkretisht, për këto fusha janë paraqitur në total 165 synime.

## ► AAK, Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore dhe Forumi E30

Ky koalicion, përmes një programi prej 101 faqeve, ka paraqitur gjashtë prioritete programore, 1) Direkt në NATO, Plani i veprimit për anëtarësim; 2) Konsolidimi demokratik dhe institucional; 3) Ndërtimi i imazhit dhe profilit shtetëror; 4) Zhvillimi ekonomik; 5) Solidariteti dhe përkrahja sociale; 6) Familja

Ndërkaq, masa dhe veprime ka paraqitur në total për 20 pika të ndryshme. Këto masa dhe veprime janë paraqitur për: anëtarësimin në NATO, për integrim në BE, për konsolidim institucional dhe demokratik, për ndërtimin e imazhit dhe profilit shtetëror, për zhvillim ekonomik, për politika makroekonomike dhe fiskale,

Po ashtu, janë përshkruar masa dhe veprime edhe për reduktim të informalitetit dhe evazionit fiskal, për lehtësira fiskale, për parandalimin e korrupsionit, për punësim; për energji elektrike, për industrinë e ushqimit dhe bujqësinë, turizëm, infrastrukturë, për mjedisin, për shëndetësinë, për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si dhe për arsimin.

Ndërkaq, krejt në fund të programit janë theksuar edhe një përmbledhje e zotimeve, përbërë prej 55 pikave.

## ► **Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës**

Ky subjekt politik, ka ofruar program prej 34 faqesh. Programi përmban tetë shtylla kryesore, ku theksohet se janë të fokusuar në fuzionimin e komunitetit Egjiptian dhe të gjithë qytetarëve.

Këto shtylla kanë të bëjnë me: Integrimin ekonomik dhe reformimin e mbështetjes sociale; Arsimimin, edukimin dhe barazinë gjinore; Përmirësimin e kushteve të banimit; Punësimin në sektorin publik dhe privat; Shëndetësinë dhe mirëqenien; Mbështetjen për kulturën dhe ruajtjen e identitetit; Mbështetjen për infrastrukturën bazë; dhe Subvencionimin e fermerëve.

## ► **Fjala**

Subjekti Fjala përmes një programi prej 15 faqesh, ka paraqitur 15 fusha kanë paraqitur angazhimin e tyre përmes 15 fushave. Këto fusha i ka ndarë në pikat: 1) Ekonomia; 2) Arsimi; 3) Shëndetësia; 4) Energjia; 5) Mirëqenia dhe familja; 6) Drejtësia; 7) Bujqësia; 8) Rendi dhe Siguria; 9) Politika e jashtme; 10) Mjedisi dhe planifikimi hapësinorë; 11) Politikat sociale dhe pensionale; 12) Sektori financiar; 13) Kultura; dhe 14) Diaspora.

Ndërkaq, për secilën prej tyre ka paraqitur edhe nënpika, konkretisht 89 nënpika në total.

## ► **Koalicioni – Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) dhe Lëvizjes për Bashkëveprim (LPB)**

Në një program të paraqitur përmes 15 faqeve, ky koalicion thekson se do të fokusohet në shtatë pika. Sipas këtij programi, pikat në të cilat do fokusohet ky koalicion kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, edukimin dhe arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, zhvillimin ekonomik dhe punësimin, banimin e qëndrueshëm dhe infrastrukturën, kulturën, rininë dhe sportin, si dhe barazinë gjinore.



## ► Koalicioni për Familje

Koalicioni për Familje ka paraqitur një program prej 104 faqeve. Në fillim të këtij programi, Koalicioni për Familje ka paraqitur parimet e programit për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Këto parime janë të ndara në 10 pika të ndryshme. Veç tjerash, këto parime përfshijnë ruajtjen dhe përparimin e rregullt kushtetues; ndërtimin e shtetit demokratik ligjor, me pushtete të ndara e të balancuara, legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe sistem kushtetues që parandalon konfliktet joparimore në mes tyre, duke siguruar shprehjen e lirë të mendimit të qytetarëve. Po ashtu, përfshihet edhe mbështetja e ushtrimit të plotë të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit të Kosovës mbi qeverinë dhe organet e tjera ekzekutive të themeluara nga ana e tij. Si parime të këtij programi, përfshihet edhe mbrojtja e lirive fundamentale, duke e luftuar çdo lloj diskriminimi; Sundimi i ligjit me punën e vendosur kundër hajdutërisë dhe krimit; Forcimi dhe fuqizimi i strukturave të sigurisë; Avancimin e sistemit edukativo-arsimor; Reformën e sistemit shëndetësor; Zhvillimin sistematik ekonomik; dhe Ngritja e vetëdijes kombëtare, ruajtjen e vlerave dhe përmirësimin e standardeve të jetesës.

Programi është i ndarë në pesë pika kryesore: 1) Familja; 2) Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Kulturë; 3) Shëndetësi dhe reformë sociale; 4) Zhvillim dhe Integrim; dhe 5) Siguria dhe Drejtësia

## ► Demokracia Serbe

Ky subjekt politik ka paraqitur një program të shkurtër, me vetëm 7 pika. Në 6 prej tyre, theksohen iniciativa specifike të cilët kanë të bëjnë me komunitetin serb. Mes tjerash, ata garantojnë mbështetje dhe siguri për qytetarët serb. Po ashtu, premtojnë se do të ushtrorjnë presion mbi Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ashtu që të punohet për kthimin e serbëve në Kosovë. Ndërsa, premtojnë ndalimin e largimit të serbëve përmes shpërndarjes më të drejtë të fondeve që derdhen në mjediset serbe në Kosovë. Më tej, në program thuhet se do të insistojnë që ndalimi për importin e mallrave dhe shtypit serb të hiqet plotësisht, si dhe se do të mbajnë lidhjet me Beogradin në nivel teknik dhe jo politik.

Përderisa, në pikën 7 kanë paraqitur edhe 8 iniciativa të tjera.

## ▶ Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë

Përmes programit prej 12 faqesh, ky subjekt ka paraqitur 10 pika apo kapituj, në drejtim të të cilave thuhet se do punojnë. Në mesin e tyre përfshihen liritë personale dhe të drejtat, decentralizimi, ekonomia, arsimi, komunitetet pakicë dhe kthimi i të zhvendosurve dhe përfshirje më të madhe e rol më aktiv të përfaqësuesve serb në Kosovë, në çështjet që lidhen me të drejtat e tyre dhe mirëqenien e përgjithshme në Kosovë.

Po ashtu, në mesin e çështjeve që përmenden në këtë program përfshihen edhe pavarësia politike, ku theksohet se përfaqësuesit e kësaj partie nuk do të ndjekin ndikimet e jashtme, qoftë nga Beogradi apo Brukseli. Ndërsa, në fund të programit përfshihen edhe çështje të punësimit, dhe atë përmes kualifikimeve profesionale dhe përmes mikro-bizneseve.

## ▶ Partia Liberale Egjiptiane

Partia Liberale Egjiptiane me programin prej 3 faqesh, ka paraqitur 11 tituj, të cilët paraqesin synime për: arsimin; forcimin e demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut; punësimin; shëndetësinë; mirëqenien; zhvillimin ekonomik, bujqësinë dhe blegtorinë; infrastrukturën; gratë; rininë, kulturën, sportin dhe mediat; si dhe diasporën. Ndërkaq, në njërin prej titujve janë paraqitur shtatë pika që kanë të bëjnë me identitetin e komunitetit egjiptian.

## ▶ Partia e Bashkuar e Goranëve

Ky subjekt ka përgatitur një program prej vetëm një faqe. Në këtë program shkurtimisht janë përshkruar 10 pika se në të cilat do të angazhohet e njëjta. Përmes këtyre pikave Partia e Bashkuar e Gorës (JGP) thekson se do të avokoj për ruajtjen dhe zhvillimin e komunitetit të Gorës, duke u fokusuar në ruajtjen e traditës, veçantisë dhe identitetit. Partia synon të adresojë problemet e përditshme të qytetarëve, duke promovuar transparencën në punësim, përfaqësimin rajonal dhe diskriminimin pozitiv për të rinjtë dhe gratë. Mes tjerash, në program thuhet se ky subjekt mbështet gjithashtu krijimin e një Kosove pro-evropiane, multikulturore dhe multietnike, me një fokus të fortë në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, fermerëve, pensionistëve, si dhe të drejtës për shërbime sociale dhe shëndetësore falas, arsim dhe punësim.

## ► Koalicioni Ynë Boshnjak

Koalicioni Ynë Boshnjak ka ofruar një program prej 24 faqesh. Përmes një kapitulli ku flitet për problemet dhe zgjedhjet, theksohen: Mungesa e komunës boshnjake; Decentralizimi dhe Krijimi i zgjidhjeve të përkohshme.

Ndërsa, pesë kapituj të tjerë kanë të bëjnë me: Arsimin, kulturën dhe identitetin; Ekonominë në zonat boshnjake; Mbrojtjen e identitetit, gjuhës, traditës dhe kulturës boshnjake; Rininë, sportin dhe artin; dhe Mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu, në secilin prej këtyre kapitujve janë theksuar edhe nëntituj, ku për këto çështje flitet më specifikisht.

## 5. Pastërtia e listave zgjedhore

Fakti se Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës tregon për rëndësinë e madhe që ky institucion të mos përbëhet nga persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptimin e aktakuzave aktive dhe dënimeve për vepra penale të ndryshme.

Instituti i Kosovës për Drejtësi në fund të vitit të kaluar publikoi një raport, përmes të cilit ka treguar për përfshirjen e personave të cilët kanë probleme me ligjin, në Qeveri dhe në Kuvend. Sipas gjetjeve të atij raporti, Kuvendi i Legjislaturës së VIII-të, ishte përbërë nga tetë deputetë me aktakuzave aktive dhe një deputete me dënim të formës së prerë<sup>11</sup>.

Fatkeqësisht, një dukuri e tillë, me shumë mundësi do vazhdojë të ndodh edhe me legjislaturën e ardhshme. Kjo për shkak se disa prej subjekteve politike, vazhdojnë që të përfshijnë në listat e tyre, kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin. Pra, ofrojnë mundësinë që populli të zgjedhë edhe persona të tillë për t'i përfaqësuar ata. Duke vazhduar të dëshmojnë mungesë të vullnetit për dekriminalizim të politikës.

Nga 28 subjekte politike të certifikuara, tre të tilla përfshijnë persona që kanë probleme me ligjin në listat e tyre të kandidatëve për deputetë. Këtu bënë pjesë Lëvizja Vetëvendosje, pastaj Lidhja Demokratike e Kosovës dhe koalicioni i AAK dhe Nisma.

Këto tre subjekte politike, së bashku, kanë në listat e tyre në total 23 persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptimin e aktakuzave aktive dhe dënimeve. Kështu, nga 330 kandidatë që kanë paraqitur të tri këto subjekte, i bie që 7% e tyre të kenë probleme me ligjin.

Subjekti politik, lista e të cilit përmban më së shumti kandidatë për deputetë, të cilët kanë probleme me ligjin, është Lëvizja Vetëvendosje, me 14 kandidatë. Shprehur në përqindje, i bie që 12.7% të kësaj liste, e përmbajnë kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin.

Kurse koalicioni AAK dhe Nisma, në listat e tyre kanë përfshirë tetë kandidatë që kanë probleme me ligjin, apo 7.3% e listës së tyre. Pesë prej tyre janë nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe tre të tjera nga Nisma.

Ndërsa, Lidhja Demokratike e Kosovës në listën e saj, ka përfshirë një kandidatë i cili ka probleme me ligjin.

---

<sup>11</sup> Shala, G. dhe Smajli, F. "Qeverisja me duar të pastra dhe hetimi i korrupsionit qeveritar". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/qeverisja-me-duar-te-pastra-dhe-hetimi-i-korrupsionit-qeveritar/>).

## 5.1. Kandidatët me aktakuza aktive

Ndërkaq, nga gjithsej 23 kandidatë që kanë probleme me ligjin, 16 prej tyre janë duke u përballur aktakuza aktive, kurse tetë janë dënuar për vepra penale<sup>12</sup>.

Në mesin e këtyre 16 kandidatëve, tre prej tyre kanë më shumë se një aktakuzë aktive. Kështu, numri total i aktakuzave aktive ndaj këtyre kandidatëve shkon në 20. Ndërsa, numri total i veprave penale shkon në 21.

Veprat penale të cilat u vihen në barrë këtyre kandidatëve, janë të natyrave të ndryshme. Përveç atyre të natyrës korruptive, si keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, në mesin e veprave penale, janë edhe katër lloje tjera të veprave penale. Bëhet fjalë për vepra penale si "*Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*", "*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*", "*Pengim i personit zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare*" dhe "*Sulm ndaj personit zyrtar*".

Vepra penale që paraqitet më së shumti në aktakuzat e ngritura ndaj këtyre kandidatëve është "*Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*", konkretisht në nëntë raste. Më pas vie vepra penale "*keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*" në gjashtë raste, "*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*" në pesë raste.

Ndërkaq, veprat penale "*Pengim i personit zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare*" dhe "*Sulm ndaj personit zyrtar*", paraqiten në nga një rast.

Në tabelën e mëposhtme gjeni të renditur të gjithë kandidatët për deputetë të cilët kanë aktakuza aktive, subjektin politike që ata i përkasin dhe veprat penale për të cilat akuzohen të njëjtit.

---

<sup>12</sup> Shënim: Një prej kandidateve është edhe në listën e kandidatëve që kanë dënime si dhe në listën e kandidatëve që kanë aktakuzë aktive.

Emri dhe Mbiemri	Subjekti Politik (Partia)	Numri i rasteve	Vepra Penale	Kur është ngritur aktakuza
Albulena Haxhiu	LVV	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2016
Arbërije Nagavci	LVV	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2019
Besnik Krasniqi	AAK-Nisma	1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2023
Drita Millaku	LDK	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
Endrit Krasniqi	AAK-Nisma	1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2024
Fitore Pacolli – Dalipi	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
Glauk Konjufca	LVV	2	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2016
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2016
Jetmire Vrenezi	LVV	1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2019
Nuredin Lushtaku	AAK-Nisma	2	Sulm ndaj personit zyrtar	2022
			Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2019
Pal Lekaj	AAK-Nisma	3	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2015
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2016
			Keqpërdorim të detyrës zyrtare	2022
Sali Zyba	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
Teuta Haxhiu	AAK-Nisma	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2016
Time Kadrijaj	AAK-Nisma	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2016
Valon Ramadani	LVV	1	Pengim i personit zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare	2019
			Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
Vesel Krasniqi	AAK-Nisma	1	Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar	2024
Xhelal Sveçla	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019

**TABELA 2** Kandidatët me aktakuza aktive.

## 5.2. Kandidatët me dënime

Në anën tjetër, nga tetë kandidatët për deputetë që kanë dënime, njëri prej tyre është i dënuar në dy raste, për vepra të ndryshme penale. Tre prej këtyre deputetëve janë të dënuar për vepra penale të natyrës korruptive, konkretisht për mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë. Për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm janë të dënuar katër kandidatë. Kurse, një kandidat është i dënuar për veprën penale "Sulm ndaj personi zyrtar" dhe "Kanosje".

Pjesën më të madhe të këtyre kandidatëve e përbëjnë ata të listës së Lëvizjes Vetëvendosje, pesë prej tyre. Kurse, një kandidatë është në listën e koalicionit AAK - Nisma.

Emri dhe Mbiemri	Subjekti Politik (Partia)	Numri i rasteve	Vepra Penale	Viti	Dënimi
<b>Albin Kurti</b>	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm Pëngimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	2018	Unik: 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht
<b>Albulena Haxhiu</b>	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm Pëngimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	2018	Unik: 1 vit e 3 muaj burgim me kusht
<b>Hydajet Hyseni – Kaloshi</b>	LVV	1	Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2022	500 euro dënim me gjobë
<b>Ismail Kurteshi</b>	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2021	4 muaj burgim me kusht
<b>Liza Gashi</b>	LVV	1	Mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2023	500 euro dënim me gjobë
<b>Mytaher Haskuka</b>	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2022	1 vit burgim me kusht
<b>Rozeta Hajdari</b>	LVV	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2022	700 euro dënim me gjobë
<b>Zafir Berisha</b>	AAK -Nisma	2	Sulm ndaj personit zyrtar	2024	1,500 euro dënim me gjobë
			Kanosje	2022	600 euro dënim me gjobë

**TABELA 3** Kandidatët me dënime për vepra penale.

Kandidatët e listuar më lartë janë vlerësuar në këtë raport si persona të cilët kanë probleme me ligjin, në kuptimin që ata kanë aktakuzë aktive, ose se janë të dënuar. Pra, jo në kuptimin që atyre iu ndalohet ligjërisht që të jenë pjesë e listave të kandidatëve. Kjo për shkak se këto ndalesa përcaktohen saktësisht me Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme. Në këtë Ligj, mes disa ndalesave tjera, theksohet se në zgjedhje nuk mund të kandidoj personi i cili është i dënuar në tri vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv.

Mirëpo, përkundër kësaj, kriminalizimi i politikës në kuptim të mbajtjes së pozitave të rëndësishme shtetërore nga zyrtarë që kanë probleme me ligjin nuk është në linjë me parimet e qeverisjes së mirë.

Çështja e qeverisjes së mirë është trajtuar edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC). Kjo konventë ka theksuar obligimin që: Secili shtet palë, në masën që është në pajtim me principet themelore të sistemit të tij ligjor, merr në shqyrtim procedurat nëpërmjet të cilave një nëpunës publik, i akuzuar për një vepër penale të parashikuar sipas kësaj Konvente, nëse është e përshtatshme, mund të largohet, pezullohet ose rëmërohet nga organi përkatës, duke pasur parasysh respektimin e principit të prezumimit të pafajësisë. Gjithashtu, kjo Konventë ka përcaktuar edhe dispozita që kërkojnë largimin e personave të dënuar.

Megjithatë, fakti se Kosova nuk është pjesë e kësaj Konvente, nuk e përjashton mundësinë që Kosova të zbatojë parimet dhe standardet që promovon kjo Konventë.



## 6. Sundimi i ligjit në programet politike

### 6.1. Lëvizja Vetëvendosje

Në faqen 49 të Plan Programit të Lëvizjes Vetëvendosje trajtohet Drejtësia. Plan Programi i Lëvizjes Vetëvendosje drejtësinë e trajton vetëm në këtë faqe. Si për nga mënyra se si është qasur Programit Politik, duke e publikuar me vonesë dhe me vetëm një faqe përmbajtje, ashtu edhe për nga premtimet e dhëna, programi për Drejtësi i Lëvizjes Vetëvendosje është një program jo serioz.

Plan Programi i Lëvizjes Vetëvendosje nuk i referohet fare Strategjisë për Sundimin e Ligjit, Strategji kjo e cila është miratuar pas zhvillimit të procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit<sup>13</sup>.

Pika e parë është themelimi i Gjykatës për çështje familjare. Themelimi i kësaj Gjykate arsyetohet me kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve familjare dhe pa asnjë analizë specifike se pse nevojitet një Gjykatë e tillë. Në fakt, pos një vlerësimi të përgjithshëm, Plan Programi nuk shqyrton as problematikën e rasteve familjare dhe as nevojën për themelimin e kësaj Gjykate.

Themelimi i një Prokurorie të re të Specializuar është pika e dytë që përmban programi i Lëvizjen Vetëvendosje për Drejtësi. As ky propozim nuk ka asnjë sqarim, derisa Kosova ka një Prokurori Speciale. Madje, në kuadër të po kësaj Legjislature, janë miratuar dy (2) Ligje për PSRK. Themelimi i një Prokurorie të tillë, nuk duket një propozim serioz.

Themelimi i Zyrës për Hetime Disiplinore është pika e tretë dhe e fundit që përmban programi i Lëvizjes Vetëvendosje për Drejtësi: "Zyra do të jetë përgjegjëse për trajtimin e ankesave dhe pretendimeve për sjellje të papërshtatshme nga gjyqtarët dhe prokurorët. Procesi disiplinor do të mund të iniciohet edhe ex-officio. Zyra do të kryejë mbledhjen e provave dhe paraqitjen e çështjeve përpara Komisioneve Disiplinore të KGJK dhe KPK" thuhet në Programin. Një zyre pothuajse identike, e cila është quajtur Zyra e Prokurorit Disiplinor, ka funksionuar në Kosovë. Dështimi i saj për të ofruar llogaridhënie ka rezultuar me ndryshim të sistemit të llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas Ligjit NR. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

---

13 Shala, G., Kolaj, A., Jakaj, N. dhe Kolshi, M. "Strategjia në udhëkryq". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Qershor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/strategjia-ne-udhekryq/>); Zekaj, E., Makshana, L., Shala, G. dhe Jakaj, N. "(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Tetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>).

Në anën tjetër, duhet theksuar se ky premtim duket të jetë po ashtu jo serioz. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë e ka proceduar në Komisionin e Venecias Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit NR. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve<sup>14</sup>. Ky Projektligj synon ta reformojë Projektligjin sipas sistemit aktual dhe themelimi i një zyre të re askund nuk përmendet.

## 6.2. Lidhja Demokratike e Kosovës

Në faqet 136-147 të Plan Programit të LDK trajtohet drejtësia. Në këtë pjesë, Plan Programi i LDK përmend problemet në fushën e sundimit të ligjit, vetingun në sistemin e drejtësisë, integritetin e sistemit të drejtësisë, vrasjet politike etj<sup>15</sup>.

Si një aspekt pozitiv, konsiderohet zotimi për zhvillimin e procesit të vetingut, në përputhje me opinionet e Komisionit të Venecias lidhur me këtë proces në Kosovë<sup>16</sup>. Plan-programi thekson se vetingu do të realizohet përmes ndryshimeve kushtetuese, të cilat do të pasohen nga miratimi i ligjeve të nevojshme për fuqizimin e sistemit të drejtësisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është premtimi për rikthimin e pavarësisë së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas, siç ishte deri në vitin 2022<sup>17</sup>. Gjithashtu, zotimi për garantimin e stabilitetit të pagave në sistemin e drejtësisë përbën një tjetër pikë pozitive të këtij plan-programi<sup>18</sup>. Po aq i rëndësishëm është edhe fokusimi në digjitalizimin e shërbimeve të drejtësisë, që përfaqëson një hap drejt modernizimit dhe përmirësimit të efikasitetit.

Megjithatë, duhet theksuar se, sa i përket problemeve të evidentuara, ky plan-program kryesisht nuk ndjek një qasje të bazuar në evidencë. Me fjalë të tjera, problemet përmenden në mënyrë të përgjithshme, por mungon një analizë specifike dhe e detajuar mbi sfidat konkrete me të cilat përballlet sundimi i ligjit në Kosovë. Për më tepër, fatkeqësisht, plani nuk përmend fare Strategjinë për Sundimin e Ligjit, e cila ka dalë nga një prej proceseve më të rëndësishme në këtë fushë, që është Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit.

Tutje, kur flet për integritetin në sistemin e drejtësisë, Plan Programi thekson nevojën për 1) fuqizim të kriterëve për dhënien e provimit të jurisprudencës, 2) fuqizimin e kriterëve për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, 3) Ndryshimin e përbërjes së KGJK, në atë mënyrë që 2/3 e gjyqtarëve të jenë nga Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit dhe 4) Rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe stafit mbështetës<sup>19</sup>.

14 Komisioni i Venecias. "1220/2024 - Opinion on the draft law on recruitment, performance evaluation, integrity control, and status of judges and prosecutors and the draft law amending the Law on the disciplinary liability of judges and prosecutors". (Shih linkun: <https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?opinion=1220&year=all>).

15 Programi Politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhjet parlamentare të përgjithshme 2025, faqe 136-147.

16 Komisioni i Venecias. "Kosovo Opinion On The Concept Paper On The Vetting Of Judges And Prosecutors And Draft Amendments To The Constitution Adopted by the Venice Commission at its 131st Plenary Session (Venice, 17-18 June 2022)". Strasbourg. 20 qershor 2022. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD\(2022\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=C-DL-AD(2022)011-e)).

17 Shala, G. "Tendencat për politizim të KPMSHCK". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë. Tetor 2022. (Shih linkun: [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Draft-Raporti\\_Tendencat-per-nderhyrje-kunderkushtetuese-ne-KPMSHCK-PDF-1.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Draft-Raporti_Tendencat-per-nderhyrje-kunderkushtetuese-ne-KPMSHCK-PDF-1.pdf)).

18 Instituti i Kosovës për Drejtësi. "Pagat në sektorin publik". Dhjetor 2022. (Shih linkun: [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/IKD\\_Projektligjin-per-Pagat-ne-Sektorin-Publik-1.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/IKD_Projektligjin-per-Pagat-ne-Sektorin-Publik-1.pdf)).

19 Programi Politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhjet parlamentare të përgjithshme 2025, faqe 136-147.

Sa i përket fuqizimit të kriterëve për provimin e jurisprudencës, mbetet e paqartë se çfarë nënkuptohet me këtë nismë. Nuk është e qartë se cilat janë kriteret specifike që do të fuqizohen dhe mbi çfarë baze është ardhur në këtë përfundim. Deri më tani, nuk ka asnjë studim që evidenton nevojën për një ndryshim të tillë dhe as Plan Programi i LDK-së nuk ofron detaje në këtë drejtim. Po ashtu, mbetet e paqartë edhe çështja e kriterëve për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për të siguruar procesin e duhur në rekrutimin e tyre, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet të fuqizohen me mekanizma adekuatë ligjorë. Kjo nevojë është e evidentuar edhe nga Komisioni i Venecias.

Sa i përket propozimit për rikompozimin e KGJK-së me të paktën 2/3 të anëtarëve nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, duhet të theksohet se legjislacioni aktual e rregullon këtë çështje. Sipas ligjit, nga shtatë (7) anëtarët që përfaqësojnë gjyqësorin, dy (2) vijnë nga Gjykata Supreme, dy (2) nga Gjykata e Apelit dhe tre (3) nga Gjykatat Themelore. Kjo përbërje përfaqëson 57.1% të anëtarëve nga Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit, që është shumë afër 2/3 (66.66%). Nga ana tjetër, duhet theksuar se numri i gjyqtarëve të Gjykatave Themelore është dukshëm më i lartë se numri i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, gjë që justifikon përfaqësimin më të lartë të Gjykatave Themelore. Ndërsa, sa i përket anëtarëve të KGJK-së të zgjedhur nga Kuvendi, kjo çështje është e rregulluar me Kushtetutë. Çdo ndryshim në këtë drejtim do të kërkonte ndryshime kushtetuese, që është një proces i ndërlikuar dhe kërkon përgatitje të gjerë. Kështu, mbetet i paqartë ky propozim i këtij Plan Programi.

Sa i përket numrit të gjyqtarëve, Plan Programi nuk jep ndonjë analizë sa duhet të jetë kjo rritje. Megjithatë, është e qartë se drejt për së drejti, numri i gjyqtarëve nuk ka të bëjë me integritetin e sistemit të drejtësisë, por me efikasitetin e këtij sistemi.

Plan Programi parasheh themelimin e Qendrës Shtetërore të Hetimeve. Por, parashihet që kjo të bëhet pas përfundimit të procesit të vetingut. Nuk është e qartë nëse një mandat qeverisës mjafton për këtë.

Tek programi për drejtësi, Plan Programi i LDK liston edhe çështjen e vrasjeve politike. Në këtë drejtim, duhet theksuar se është legjitime kërkesa e këtij subjekti, sikurse e gjithë shoqërisë kosovare, për zbardhjen e këtyre vrasjeve<sup>20</sup>. Megjithatë, trajtimi i këtyre rasteve mbetet në kompetencë të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe një Plan Program politik nuk ka se çfarë premtion për këtë pjesë (ashtu siç edhe nuk ka bërë). Aq më pak, që kjo pjesë të futet tek kapitulli i drejtësisë.

Sa i përket trajtimit të krimeve të luftës, LDK nuk paraqet asnjë vizion për këtë pjesë, përjashtimisht zotimit të saj për angazhim në këtë fushë.

---

20 Frrokaj, J. dhe Hashani, G. "Trajtimi i vrasjeve në Kosovë". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prill 2021. (Shih linkun: [https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/IKD\\_Trajtimi-i-vrasjeve-ne-Kosove.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/IKD_Trajtimi-i-vrasjeve-ne-Kosove.pdf)).

### 6.3. Partia Demokratike e Kosovës

Në faqet 37-40 të Plan Programit të PDK-së gjendet kapitulli "Drejtësi e reformuar për Kosovën". Në kuadër të këtij kapitulli, Plan Programi i PDK përmban gjithsej 14 pika<sup>21</sup>.

Fillimisht, duhet theksuar se është shumë problematike anashkalimi i Strategjisë për Sundimin e Ligjit, e cila Strategji ka dalë nga një prej proceseve më të rëndësishme në këtë fushë, që është Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit<sup>22</sup>.

Fillimisht, Plan Programi i PDK thekson miratimin e Strategjisë kundër Korrupsion dhe forcimin e politikave dhe mekanizmave për luftimin e korrupsionit<sup>23</sup>. Si aspekt pozitiv konsiderohet synimi për rishikimin e legjisllacionit dhe politikave që mundësojnë luftimin në mënyrë efikase të korrupsionit. Zhvillimi i procesit të vetingut në pajtim me opinionin e Komisionit të Venecias<sup>24</sup> paraqet po ashtu një nevojë reale për sistemin e drejtësisë.

Si shumë pozitive konsiderohet edhe plani për lirim të ngarkesës me lëndë civile në sistemin gjyqësor, përmes përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga ligjet e aplikueshme dhe kontratat kolektive<sup>25</sup>. Hartimi i një "strategji[e] të veçantë për uljen e numrit të lëndëve nëpër gjykata, e cila do ta rishikojë edhe sistemin e vendosjes në organet administrative, në mënyrë që gjykatat të mos ngarkohen më shumë me lëndë" konsiderohet si një veprim plotësisht adekuat për respektimin e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e gjyqësorit për respektim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Për këtë, Plan Programi thekson edhe vlerësimin e nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve.

Plan Programi i PDK synon të themelojë Byronë Kombëtare të Hetimit. Sipas këtij Plan Programi "Karakteristikë e këtij institucioni të ri, i cili do të përbëhet nga jo më shumë se dhjetë prokurorë të specializuar, do të jetë policia gjyqësore që do t'i trajtojë të gjitha rastet kur ka dyshime për keqpërdorim të detyrës zyrtare apo kur bien ndesh me ligjin gjyqtarët, prokurorët dhe stafi mbështetës i sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ky mekanizëm, po ashtu, do të jetë kompetent për t'i trajtuar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në rastet kur PSRK nuk ndërmerr veprime sipas kompetencës së saj". Në mënyrën e prezantuar, kjo Byro nuk është një propozim adekuat. Fillimisht, në mënyrën e prezantuar, kjo Byro do të jetë një lloj "mbikëqyrësi penal" i sistemit prokurorial dhe gjyqësor dhe një Prokurori subsidiare në rastet e mos veprimit të PSRK. Kjo qasje paraqet dublifikim të përgjegjësisë institucionale, një qasje kjo kundër produktive. Tutje, parashihet që ky organ të bëjë edhe hetimin e pasurisë së pajustificueshme, term ky që i referohet konfiskimit me bazë civile. Ky synim është i paqartë.

21 Programi Zgjedhor 2025; Kosova mundet ma mirë; Bedri Hamza për Kryeministër, faqe 37-40

22 Shala, G., Kolaj, A., Jakaj, N. dhe Kolshi, M. "Strategjia në udhëkryq". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Qershor 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/strategjia-ne-udhekryq/>); Zekaj, E., Makshana, L., Shala, G. dhe Jakaj, N. "(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Tetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>).

23 Shala, G. "Saga e Strategjisë kundër Korrupsion". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Janar 2025. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2025/01/Raporti-final-Saga-e-Strategjise-kunder-Korrupsion-2.pdf>).

24 Komisioni i Venecias. "Opinion On The Concept Paper On The Vetting Of Judges And Prosecutors And Draft Amendments To The Constitution Adopted by the Venice Commission at its 131st Plenary Session (Venice, 17-18 June 2022)". Strasbourg, 20 qershor 2022. (Shih linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2022\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2022)011-e)).

25 Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe studentët e Klinikës Ligjore të IKD. "Kosotoja e pagave jubilarë të papaguara". Shtator 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/09/IKD-Kosto-e-pagave-jubilar-te-papaguara-2.pdf>).

Në anën tjetër, mungesa e ndjekjes adekuate të korrupsionit nuk është si pasojë e mungesës së mekanizmave institucional. Kryesisht, është rezultat i korporatizmit të KPK<sup>26</sup>. Në bazë të Kushtetutës, një organ si ky, i përbërë me Prokurorë, duhet të jetë pjesë e sistemit prokurorial. Si rrjedhojë, pa marrë parasysh se si quhet, paraqet thjesht një zyrë prokuroriale më shumë, që dublifikon kompetencat institucionale.

Sa i përket krimeve të luftës, programi i PDK përmban veprim specifik: Miratimin e Strategjisë kombëtare për Krimet e Luftës. Një Strategji e tillë i ka munguar Kosovës vazhdimisht dhe një planifikim i tillë konsiderohet adekuat në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës.

Sa i përket kontesteve të punës, Plan Programi synon të themelojë një Gjykatë të Punës. Megjithatë, Plan Programit i mungon një analizë në lidhje me atë se pse është e nevojshme një Gjykatë e tillë dhe pse problemet në këtë sektorë nuk mund të adresohen në kuadër të Gjykatave të rregullta. Thjesht themelimi i një Gjykatë të veçantë në një fushë të caktuar nuk zgjidhë problemin në atë fushë.

## 6.4. Koalicioni AAK - Nisma

Sipas Plan Programit të koalicionit AAK-NISMA "Sundimi i ligjit është vendosur si prioritet kryesor i qeverisjes". Në Plan Programin këtij koalicioni, përmenden zbatimi disa "niveleve të politikave", siç janë "Llogaridhënia në sundimin e ligjit, - Kthimi i dinjitetit dhe pavarësimi i institucioneve të sundimit të ligjit; Përgjegjësia institucionale efektive; Drejtësi e pavarur; Intervenimet e drejtpërdrejta në politikat publike të sundimit të ligjit dhe drejtësisë"<sup>27</sup>. Megjithatë, sa i përket sundimit të ligjit, Plan Programi nuk ofron propozime konkrete në lidhje me mënyrën se si ky koalicion do ti qasej sundimit të ligjit.

Propozimi i Plan Programit të koalicionit AAK-Nisma se "Do të krijohet një platformë e rregullt konsultimi, e hapur për publikun, me institucionet e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, për të identifikuar vështirësitë" nuk është i qartë. Fuqizimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (të cilës i referohet si Agjencia kundër Korrupsion) përmendet pa u shoqëruar me ndonjë propozim konkret<sup>28</sup>. Në mënyrë të përgjithshme përmenden edhe veprime të tjera të ndërlidhura me fushë e sundimit të ligjit apo luftimit të korrupsionit<sup>29</sup>.

26 Shala, G. dhe Kabashi, F. "Si duket korporatizmi dhe pandëshkueshmëria në sistemin prokurorial". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2024. (Shih linkun: [file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Final-Draft-raporti-Si-duket-korporatizmi-dhe-pan-deshkueshmëria-ne-sistemin-prokurorial-FINAL%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/ikd20/Downloads/Final-Draft-raporti-Si-duket-korporatizmi-dhe-pan-deshkueshmëria-ne-sistemin-prokurorial-FINAL%20(1).pdf)).

27 Programi Zgjedhor 2025 i Koalicionit AAK - Nisma, fq.25-26.

28 Po aty, fq.28.

29 Po aty, fq. 28 dhe 47-49.

## 6.5. Drejtësia në programet tjera

Plan Programi i Koalicioni për Familjen liston 15 pika që kanë të bëjnë me drejtësinë. Por, Plan Programi nuk përmban elaborim në lidhje me kuptimin dhe mënyrën e implementimit të këtyre pikave. Në kuadër të këtyre pikave bënë pjesë procesi i vetingut, "sistem[i] digjital i qasjes së noterëve në të dhëna personale për mbrojtjen e trashëgimtarëve ligjor, e veçanërisht grave nga cenueshmëria në trashëgimi", "Përcaktim[i] me ligj të buxhetit për kompensimet financiare për shujta, paga jubilarë dhe pagën e trembëdhjetë për të punësuarit në sektorët publik, në mënyrë që të shkarkohen gjykatat nga shqyrtimi i mijëra lëndëve të kësaj natyre" etj. Ndërsa, disa pika janë paraqitur si pika të përgjithshme, që nuk paraqesin një masë specifike në fushën e sundimit të ligjit, si vie fjala "Angazhim[i] i vendosur kundër krimit, me qëllim të shtimit të sigurisë për qytetarët", "Reforma që kanë për qëllim zvogëlimin e korrupsionit" etj<sup>30</sup>.

Programi i partisë Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës nuk përmban një plan në lidhje me çështjet të cilat ndërliken me sundimin e ligjit. – Koalicioni ynë Boshnjak - Programi politik i Partisë Liberale Egjiptiane 2025 – Programi politik i Partisë Liberale Egjiptiane 2025 – Partia e Bashkuar Gorane - as Programi Zgjedhor i Demokracisë Serbe -

Programi politik i PDAK-LPB përmend vetëm në mënyrë parimore rëndësinë e sundimit të ligjit dhe angazhimin e saj për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit ashkalinjë.

Partia Fjala ka përmendur në mënyrë të përgjithshme 6 masa që lidhen me drejtësinë, pa ofruar sqarime specifike mbi përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të tyre<sup>31</sup>.

30 *Programi Politik Zgjedhor 2025-2028*; fq. 99-100. Koalicioni për Familjen; Janar 2025; (Shih linkun: <https://heyzine.com/flip-book/0fa86d7e72.html>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025).

31 *Programi Politik i FJAL S – Zgjedhjet 2025*; Partia Fjala; Janar 2025; (Shih linkun: <http://www.partiafjala.com/lajme/programi-politik-i-fjal%1%91s-zgjedhjet-2025-2/>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)

# 7. Qeverisja e mirë dhe të drejtat e njeriut në programet politike

## 7.1. Lëvizja VETËVENDOSJE

Programi elektorale i Lëvizjes VETËVENDOSJE! për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 paraqet qasje të njëanshme dhe të mangët ndaj parimeve thelbësore të qeverisjes së mirë. Në asnjë pjesë të tij nuk trajtohet administrata publike, transparenca institucionale, barazia gjinore, llogaridhënia apo qeverisja me duar të pastra. Mungesa e këtyre elementeve nuk duket të jetë vetëm një lëshim teknik, por tregues i qartë i një paradigme të kufizuar të qeverisjes. Siç shihet nga leximi i programit, kjo lëvizje e redukton programin në një listë projektsh infrastrukture, duke e shmangur diskutimin për çështjet kyçe të qeverisjes.

Gjatë mandatit të Qeverisë Kurti 2, reformat në administratën publike kanë qenë objekt i kritikave të ashpra nga organizatat institucionale ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Ligji për Zyrat Publike dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publik u rrëzuan pjesërisht, duke dëshmuar mungesën e një qasjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në rregullimin e sistemit publik. Këto ligje ishin të rëndësishme për rritjen e efikasitetit dhe profesionalizimit të administratës publike, por procesi i hartimit dhe miratimit të tyre u karakterizua nga vendime të njëanshme dhe në kundërshtim me parimet kushtetuese e standardet ndërkombëtare. Në vend që të ndërtohet një administratë publike të depolitizuar dhe meritokratike, procesi legjislativ u kthye në një betejë politike që cenoi përpjekjet për reformë të thellë në administratën publike

Ligji për Pagat në Sektorin Publik mbetet ende i pazbatuar në tërësi, për shkak të shkeljes flagrante të aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Në vend që të zbatohet vendimi i Gjykatës për të përcaktuar vlerën e përvojës së punës në 0.5% për çdo vit, Qeveria dhe Kuvendi vendosën një skemë diskriminuese, ku për 15 vitet e para përvoja vlerësohet me vetëm 0.25% dhe vetëm pas kësaj periudhe aplikohet përqindja e plotë.

Fokusi i programit në projekte infrastrukture, duke lënë anash reformën në administratën publike, është strategji e mangët që shfaq vizion të kufizuar për zhvillimin e shtetit. Administrata publike është themeli mbi të cilin ndërtohet qeverisja efikase dhe e përgjegjshme, dhe injorimi i kësaj fushe në programin elektorale është sinjal alarmi për mungesën e vullnetit për të garantuar një qeverisje të qëndrueshme dhe transparente. Ndërkohë që projektet infrastrukture janë të rëndësishme, pa administratë të aftë dhe të pavarur, ato rrezikojnë të menaxhohen keq dhe të mos arrijnë ndikimin e synuar në zhvillimin e vendit.

Mungesa e vizionit për administratën publike dhe qeverisjen e mirë në programin elektorale të Lëvizjes VETËVENDOSJE! nuk është thjesht harresë, por një zgjedhje politike që pasqyron tendencën për të shmangur temat që kërkojnë llogaridhënie dhe përgjegjësi institucionale. Kjo

qasje e redukton programin në një katalog projektsh të cilat, pa reforma themelore, rrezikojnë të mbeten të paqëndrueshme. Për më tepër, shkelja e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe deformimi i ligjeve kyçe si ai për Pagat në Sektorin Publik, dëshmojnë sjellje autoritare dhe mungesë të vërtetë të angazhimit për sundimin e ligjit. Nëse ky është drejtimi që synon qeverisja e ardhshme, atëherë perspektiva e një administrate të përgjegjshme, meritokratike dhe transparente mbetet e zymtë.

## 7.2. Partia Demokratike e Kosovës

Në programin elektoral të PDK-së, vërehet që i është kushtuar rëndësi transparencës si aspekt i qeverisjes së mirë ku ajo përmendet 17 herë në 62 faqe program elektoral.

Transparencë tek ndërmarrjet publike, transparencë në arsim tek treguesit e performancës, transparencë tek institucionet mjedisore, transparencë në procesin e vetingut për aq sa lejon ligji, transparencë në punën e sistemit të drejtësisë, transparencë tek veprimet qeveritare, dialog të hapur dhe transparencë me shoqërinë civile, transparencë dhe konsultime të gjera me qytetarët për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë janë indikatorët që PDK ka llogaritur për një qeverisje të mirë nëse atë do ta votonin qytetarët e Kosovës.

Megjithatë, çështjet e përmendura në këtë program tregojnë vetëm situatat e përgjithshme dhe jo veprimet konkrete, sikurse që nuk është specifikuar se çka nënkupton transparenca tek ndërmarrjet publike, çka nënkupton me transparencën qeveritare, a bëhet fjalë për vendimet e qeverisë, dokumenteve si projektligje dhe koncept dokumente, të cilat tashmë janë duke u publikuar.

Ndërsa, në disa çështje si dialog të hapur dhe transparencë me shoqërinë civile nuk është specifikuar se çka nënkupton ky premtim, përkundër që premtime të tilla janë edhe obligime ligjore sipas Rregullores së Punës së Qeverisë<sup>32</sup> e jo në nivelin e premtimit për marrjen e besimit të qytetarëve. Nuk mund të bëhet premtim transparenca dhe konsultimet e gjera me qytetarët për dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, kur kihet parasysh se besimi që i ipet një partie politike për të qeverisë me vendin është edhe besimi që ajo do të dialogojë me Serbinë e të raportojë në Kuvendin e Kosovës para deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Në dy faqe, PDK i ka kushtuar administratës publike, ku njëri ndër synimet do të jetë rivendosja e sistemit të karrierës në administratë, duke eliminuar sistemin e mandateve të vendosur nga qeveria aktuale<sup>33</sup>, ku sipas PDK-së ka kontribuar në politizimin e administratës, ndërsa vëmendje e veçantë do t'i kushtohet krijimit të një sistemi të mirëfilltë të vlerësimit të performancës, i cili do të fillojë me ministrat dhe do të zbatohet në të gjitha nivelet e administratës. Sa i përket performancës, së administratës publike ajo është tashmë e rregulluar me akte nënligjore, përderisa nuk është treguar në mënyrë precize se si do të matet performanca e ministrave, përderisa edhe kjo është e rregulluar me Ligjin për Qeverinë, në kuptimin që Zyra e Kryeministrit sipas këtij ligji e ka për detyrë drejtimin dhe koordinimin e procesit të monitorimit të performancës së Qeverisë.<sup>34</sup>

32 Programi Zgjedhor 2025; Kosova mundet ma mirë; Bedri Hamza për Kryeministër, fq. 59.

33 Programi Zgjedhor 2025; Kosova mundet ma mirë; Bedri Hamza për Kryeministër, fq. 43.

34 Nënparagrafi 3.5 i Nenit 19, Ligji për Qeverinë: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66686>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)



Është premtuar që do të rriten kapacitetet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, por nuk është konkretizuar kjo rritje, sa është shuma që do të rritet në raport me buxhetin aktual dhe për çfarë do të shpenzohen ato mjete.

Sa i përket, zgjerimit të gamës së programeve trajnuese në Institutin e Kosovës për Administratës Publike, PDK nuk tregon se cilat janë ato gama që do t'i shtohen, cilat ka nevojë ky institut dhe pse duhet të shtohen ato fusha të tjera.

Për qeverisjen elektronike dhe digjitalizimin e administratës, tregohet që ato janë esenciale për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që qytetarët marrin dhe për luftën kundër korrupsionit. Por, sërish nuk tregohet se si do të thjeshtohen, kur do të nisë së zbatuari, si do të ulet kostoja, nuk merret asnjë shembull praktik për ndonjë shërbim që do të pësojë ndryshim dhe në këtë program nuk tregohet se si do të ulë korrupsionin kjo masë.

Programi i PDK-së është vetëm i përgjithshëm dhe nuk përmban idenë e qartë se si PDK planifikon të duket administrata publike nën qeverisjen e saj.

Kandidati për Kryeministër nga PDK, Bedri Hamza, jep zotimin se program i tij është i realizueshëm dhe do të zbatohet në qeverisjen e tij nga ministra kompetentë por që në asnjërin nga faqet nuk thuhet se ata duhet të mos jenë në ndjekje penale ose të mos kenë kanë pasur aktakuza apo të mos jenë dënuar ndonjëherë.

Në raport me përfshirjen e publikut në vendimmarrje vetëm në një rast tregohet që do të përfshihet shoqëria civile, ekspertët, akademikët, zyra e BE-së dhe ambasadat e shteteve mike – vetëm në rastin e premtimit për realizimin e vetingut të plotë në drejtësi. Kjo tregon se përfshirja e publikut është e kufizuar dhe nuk reflekton angazhim të gjerë për transparencën dhe pjesëmarrjen e shoqërisë në proceset vendimmarrëse.

Programi qeverisës i PDK-së nuk e trajton barazinë gjinore si një prioritet të qartë dhe të veçantë, përveç një referimi të përgjithshëm për gratë në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave trashëgimore. Ndërsa përmendet rritja graduale e numrit të noterëve, kjo nuk është e mjaftueshme për t'i adresuar nevojat e barazisë gjinore në fusha më të gjera si ekonomia, arsimit dhe politika. Kjo lë të nënkuptojë se PDK-ja nuk ka plan të qartë dhe gjithëpërfshirës për avancimin e barazisë gjinore.

Në programin e tyre për zgjedhjet e 9 shkurtit, të drejtat e njeriut përmenden një herë në kapitullin "*Një Kosovë e fortë dhe e përgatitur për çdo sfidë*", ku kjo çështje lidhet më shumë me çështjet e sigurisë. Ndërsa herën e dytë, të drejtat e njeriut përmenden në premtimin për ndërtimin e Memorialit të Gjenocidit në Kosovë.<sup>35</sup>

---

35 Programi Zgjedhor 2025; Kosova mundet ma mirë; Bedri Hamza për Kryeministër, fq. 49.

Të drejtat e njeriut, PDK-ja ka paraparë t'i zbatojë edhe përmes angazhimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja dhe OSBE-ja. Kjo parti përmend se këto të drejta do të zgjerohen edhe përmes anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Për herë të fundit, PDK-ja përmend të drejtat e njeriut në masën 10 të kapitullit për Politikën e Jashtme të Kosovës, ku premtim promovimin dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtat e pakicave në rajon përmes mekanizmave të BE-së, Këshillit të Evropës dhe OSBE-së.

Nga leximi i këtij program vërehet që ka mungesë të fokusit të drejtpërdrejtë në të drejtat e njeriut. Përqëndrimi tek siguria, shkakton mungesë të theksuar të fokusit mbi aspektet sociale, kulturore dhe ekonomike të të drejtave të njeriut. Programi nuk përmend asnjë masë konkrete për adresimin e diskriminimit, barazinë gjinore, ose të drejtat e grupeve të cenuara brenda Kosovës.

Në raport është dashur të vendosej një kapitull i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut brenda vendit, duke përfshirë mekanizma për monitorim dhe implementim. Programi elektorale i PDK-së do të kishte përfituar shumë nga përfshirja e një kapitulli të veçantë të dedikuar vetëm për të drejtat e njeriut, ku të parashikohen angazhime dhe masa të qarta për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave.

Nga leximi i programit të PDK-së, mund të konkludojmë se ai është shumë më i fokusuar në promovimin e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar, veçanërisht përmes angazhimit në organizata si BE dhe OKB, por ka më pak fokus mbi nevojat dhe zhvillimet e brendshme.

Një aspekt pozitiv që mund të përmendet është angazhimi i qartë për komunitetin jo shumicë serb ku kjo parti premtim në mënyrë të qartë dialog me këtë komunitet në mënyrë që ata të integrohen në jetën sociale dhe politike të Kosovës.<sup>36</sup>

### 7.3. Lidhja Demokratike e Kosovës

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka vendosur transparencën si një nga parimet kryesore të programit të saj zgjedhor për 9 shkurtin, duke e trajtuar atë si element të rëndësishëm për zhvillimin institucional dhe luftimin e korrupsionit. Në këtë kuadër, LDK premtim ndryshimin e ligjit të prokurimit për të rritur efikasitetin, transparencën dhe mbështetjen për kompanitë vendore, si dhe vendosjen e kritereve të qarta për përzgjedhjen e kompanive në projekte publike.<sup>37</sup> Megjithatë, programi dështon të sqarojë në mënyrë të mjaftueshme sfidat dhe problemet konkrete të ligjit aktual të prokurimit publik, duke lënë një mangësi në përshkrimin e pasigurisë dhe dobësive që dëmtojnë transparencën dhe efikasitetin e procedurave.

LDK ka prioritet digjitalizimin për t'i përmirësuar shërbimet publike dhe rritur transparencën e administratës publike. Programi përfshin krijimin e platformave online për regjistrime tatimore, rinovimin e licencave dhe menaxhimin e lejeve ndërtimore, duke synuar një administratë më efikase dhe të qasshme për qytetarët. Po ashtu, përfshihet edhe digjitalizimi i teksteve mësimore dhe matja e performancës në arsim për të rritur transparencën dhe llogaridhënien. Megjithatë,

<sup>36</sup> Programi Zgjedhor 2025, Kosova mundet ma mirë, Bedri Hamza për Kryeministër, fq. 62

<sup>37</sup> Programi Politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhjet parlamentare të përgjithshme 2025, fq. 45.

programi nuk ofron detaje mbi koston financiare dhe burimet e nevojshme për zbatimin e projekteve të digjitalizimit, duke lënë pasiguri në lidhje me realizimin e tyre.

Në drejtësi, LDK synon publikimin e dokumenteve gjyqësore në platforma publike për të siguruar transparencë dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në sistemin gjyqësor. Megjithatë, LDK siç shihet nuk e ka informatën e saktë se dokumentet gjyqësore janë të publikuara<sup>38</sup> ose nuk ka arritur të shpjegojë në mënyrë të qartë se cili është premtimi i tyre për këtë çështje.

Krijimi i platformave për menaxhimin e lejeve ndërtimore është gjithashtu hap i mirë që synon të rrisë përgjegjësinë dhe transparencën. Sidoqoftë, mungesa e një plani të qartë për ndarjet buxhetore dhe mbështetjen financiare për këto masa mund të dëmtojë besueshmërinë e programit.

LDK synon modernizimin e administratës publike duke theksuar transparencën, përgjegjësinë dhe efikasitetin, si dhe forcimin e qeverisjes në nivel lokal. Përmes kësaj strategjie, synohet një shpërndarje e drejtë e projekteve dhe pensione, në përputhje me prioritetet e komunave. Megjithatë, programi nuk analizon gjendjen aktuale të administratës publike dhe nuk ofron informacion mbi burimet financiare dhe njerëzore që do të përdoren për të realizuar këto objektiva.

Sa i përket barazisë gjinore, LDK ka përfshirë disa iniciativa në fusha si teknologjia e informacionit, familja dhe politika e jashtme. Megjithatë, trajtimi i kësaj teme mbetet sipërfaqësor dhe nuk adreson çështje kyçe si paga e barabartë, përfaqësimi gjinor në pozita udhëheqëse dhe mbështetja për viktimat e dhunës. Për një qasje më gjithëpërfshirëse, programi do të duhej t'i kushtonte një kapitull të veçantë kësaj teme.

Në aspektin e qeverisjes dhe integritit euro-atlantik, LDK propozon forcimin e institucioneve shtetërore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si elementë kyç për përsheptimin e integritit në BE dhe NATO. Një nga iniciativat pozitive është amendamenti kushtetues për garantimin e të drejtës për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.<sup>39</sup> Megjithatë, programi nuk përmend përfshirjen e komuniteteve jo shumicë në këtë proces, çka është thelbësore për miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe garantimin e gjithëpërfshirjes.

## 7.4. Koalicioni AAK-Nisma

Programi elektoral i AAK-së fokusohet në konsolidimin institucional dhe demokratik përmes masave konkrete që promovojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe organizatave. Ai thekson nevojën për avancimin e e-qeverisjes, krijimin e një platforme kombëtare për monitorimin në kohë reale të shpenzimeve publike, dhe hartimin e një strategjie për përmirësimin e transparencës në industrinë e rëndë dhe planifikimin rajonal. Ndërsa programi ka qartësi dhe fokus të mirë në disa fusha, mungesa e detajeve mbi mënyrën e zbatimit dhe sigurimit të koordinimit efektiv ngre pyetje mbi realizueshmërinë e këtyre objektivave.

38 Këshilli Gjyqësor i Kosovës; (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)  
39 Programi Politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës për zgjedhjet parlamentare të përgjithshme 2025, fq. 183.

Programi zgjedhor i AAK-së për administratën publike fokusohet në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës, duke mbështetur projekte që vlerësojnë cilësinë e shërbimeve dhe performancën e administratës përmes vlerësimeve të opinioneve.

AAK ka premtuar rritje të pagave të administratës çdo vit, në përputhje me rritjen ekonomike dhe inflacionin. Ajo po ashtu do të mbështesë zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, përmes reformave ligjore për të reduktuar barrierat dhe kostot e biznesit. Synimi është të reduktohet informaliteti dhe korrupsioni, duke krijuar partneritet më të qëndrueshëm shtet-biznes. Megjithatë, programi nuk ofron detaje të mjaftueshme mbi mënyrën e realizimit të partneritetit shtet-biznes dhe masat specifike që do të merren për rritjen e efikasitetit të administratës. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratë janë të paraqitura si prioritetet të përgjithshme, por mungon një plan i qartë dhe i detajuar për implementimin e këtyre masave gjatë periudhës së mandatit. Në anën tjetër, rritja e pagave nuk mund të jetë tashmë prioritet sepse tanimë është krijuar standardi ku përmes rritjes ekonomike përcaktohet edhe vlera e koeficientit për pagat në sektorin publik.<sup>40</sup>

Programi elektorale i AAK-së thekson rëndësinë e fuqizimit të institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Agjencia Kundër Korrupsionit, por mungojnë detaje konkrete mbi mënyrën e realizimit të këtij qëllimi. Edhe pse premtim zhvillim ekonomik dhe luftë kundër korrupsionit, lidhja ndërmjet këtyre politikave dhe mekanizmave specifikë mbetet e paqartë. Përmenden raportimet ndërkombëtare për korrupsionin, kodet e etikës dhe konsultimet me median dhe shoqërinë civile, por mungon fokusi i drejtpërdrejtë në qeverisje me duar të pastra dhe integritet të plotë.

Programi përqendrohet në barazinë gjinore dhe mbështetjen për gratë, duke theksuar balancimin e jetës familjare dhe karrierës, si dhe krijimin e mundësive profesionale. Përkrahja për projekte që synojnë punësim të qëndrueshëm dhe fuqizimin e rinisë përmendet si prioritet. Megjithatë, programi nuk përmban masa konkrete dhe të qarta për zbatimin e këtyre synimeve, duke lënë pasiguri mbi realizimin e tyre.

Avancimi i kornizës ligjore për të inkurajuar transparencën, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien në proceset politike është një tjetër synim i AAK-së. Por programi nuk sqaron masa konkrete për përfshirjen e publikut në proceset ligjvënëse dhe nuk ofron qartësi mbi mënyrën e realizimit të këtyre reformave. Ideja për një platformë digjitale për transparencën e shpenzimeve publike dhe projekteve qeveritare është premtuese, por kërkon më shumë detaje për zbatimin praktik.

Pavarësisht objektivave të deklaruara, programi mbetet i mangët në përshkrimin e veprimeve konkrete dhe burimeve që do të mbështesin zbatimin e politikave të propozuara. Mungesa e një plani të qartë për financimin dhe implementimin e masave e bën të vështirë vlerësimin e realizueshmërisë së tyre.

Në përgjithësi, ndonëse programi përfshin ide të rëndësishme për fuqizimin institucional, barazinë gjinore dhe transparencën, ai duhet të plotësohet me strategji konkrete dhe hapa të qarta për të siguruar zbatimin e synimeve të tij.

---

40 Neni 32, Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)

## 7.5. Koalicioni për Familje

Koalicioni për Familjen ka prezantuar program elektoral që fokusohet në transparencën dhe bashkëpunimin me qytetarët për adresimin e sfidave në shëndetësi, drejtësi, siguri dhe ekonomi. Programi përfshin premtime për proces të hapur të vlerësimit të strukturave udhëheqëse dhe menaxhuese në institucionet kryesore shëndetësore, si dhe publikimin e të dhënave mbi shpenzimet buxhetore dhe procedurat e tenderimit. Ndërsa këto janë hapa të rëndësishëm, transparenca në tenderime dhe publikimi i shpenzimeve tashmë janë praktika që një pjesë e institucioneve e bëjnë e për më shumë ka një faqe ku transparenca në prokurim është duke u implementuar, në anën tjetër për publikimin e shpenzimeve programi elektoral i këtij koalicioni nuk e qartëson se si do të bëhen këto përmirësime konkrete.

Për sa i përket sistemit të drejtësisë, megjithëse sigurohet përkushtim ndaj pavarësisë dhe transparencës, mungojnë detaje konkrete mbi reformat e propozuara dhe si do të tejkalohen platformat ekzistuese. Në përgjithësi, propozimet reflektojnë prioritetet kyçe, por mungon konkretizimi i masave dhe mekanizmave të implementimit.

Programi elektoral i Koalicionit për Familje synon modernizimin e administratës publike dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale, duke propozuar krijimin e Institutit Shtetëror për Teknologji Informative<sup>41</sup> për të mbështetur administratën dhe zhvillimin e data-qendrave të sigurta në lokacione strategjike. Megjithatë, ai nuk ofron qartësi lidhur me premtimin për ekzekutimin specifik të Ligjit për Pagat, duke pasur parasysh se ky ligj tashmë është në zbatim. Gjithashtu, referenca ndaj Ligjit për Shërbimin Civil është e pavlefshme, pasi ky ligj është zëvendësuar nga Ligji për Zyrtarët Publikë që nga viti 2023. Programi, përfshin elemente të agjendës evropiane dhe synimet integruese të Kosovës, ajo nuk arrin të tregojë në mënyrë specifike cilat janë problemet dhe cilat janë kërkesat.

Mungesa e një angazhimi në programin elektoral të Koalicionit për Familjen që garanton se nuk do të emërojë ministra ose kryeministër me aktakuza, me mungesë integriteti ose të kaluar kriminale, mund të nënkuptojë se ky koalicion nuk e ka prioritetizuar vendosjen e standardeve të larta etike për pozitat publike nëse arrin t'i marrë në rast të rezultatit të suksesshëm në zgjedhje. Mungesa e deklaramit zyrtar në program elektoral, tregon dhe nuk lë hapësirë për interpretime tjetër, përveç që ky koalicion mund të përfshijë ministra e zyrtarë të tjerë që kanë pasur aktakuza për korrupsion ose që janë në ndjekje penale.

## 7.6. Partia Liberale Egjiptiane

Programi elektoral i Partisë Liberale Egjiptiane fokusohet në çështje të rëndësishme si barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut, duke ofruar disa premtimesh specifike. Ky program propozon rritjen e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse, mbrojtjen nga diskriminimi gjinor dhe zhvillimin e politikave që mbështesin gratë në biznes. Po ashtu, programi përfshin masa për të siguruar treg për produktet artizanale dhe bujqësore të grave, si dhe për të parandaluar dhunën në familje dhe martesat e hershme përmes fushatave vetëdijesuese. Në fushën e të drejtave të

41 Programi Politik Zgjedhor 2025-2028; Koalicioni për Familjen; Janar 2025; (Shih linkun: <https://heyzine.com/flip-book/0fa86d7e72.html>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)

njeriut, premtohet krijimi i ligjeve për të dënuar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin, monitorimi i institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe forcimi i mekanizmave për parandalimin dhe rehabilitimin e fëmijëve që kërkojnë lëmoshë.

Megjithatë, programi është i kufizuar, me vetëm tre faqe, dhe lë jashtë disa tema të rëndësishme që lidhen me qeverisjen e mirë dhe transparencën. Nuk përmendet asnjë angazhim për llogaridhënie, përzgjedhjen e ministrave pa aktakuza dhe me integritet, apo masat për qeverisje me duar të pastra dhe raportim ndaj publikut. Përkundër përfshirjes së kapitujve të shkurtër për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, trajtimi i tyre mbetet sipërfaqësor dhe jo i detajuar. Kjo mos përfshirje e prioriteteve bazike për qeverisje transparente dhe të ndershme e bën programin të paplotë dhe të paekuilibruar, duke e kufizuar fuqinë e tij për të adresuar tërësisht sfidat që përballen qytetarët dhe institucionet.

## 7.7. PDAK-LPB

Programi elektoral i PDAK-LPB përqendrohet kryesisht në promovimin e barazisë gjinore, duke theksuar se të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e grave dhe burrave duhet të jenë të barabarta, pa u përcaktuar nga gjinia. Megjithatë, ai mbetet shumë i shkurtër, me vetëm tre faqe përmbajtje, dhe nuk trajton aspekte qenësore të qeverisjes si transparencja, llogaridhënia, qeverisja e pastruar nga aktakuza, dhe integriteti i ministrave. Programi përfshin masa të rëndësishme për fuqizimin e gruas, si ndryshimi i ligjit për të drejtat e gruas dhe mbështetje për pjesëmarrjen e saj në vendimmarrje, por nuk specifikohet saktësisht se cilat ligje do të ndryshohen për të arritur këto qëllime. Duket se ka një angazhim të qartë për barazinë gjinore, por kërkohet më shumë detaj për të kuptuar hollësisht masat konkrete dhe aplikimin e tyre.

Programi elektoral i PDAK-LPB fokusohet në avancimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetin Ashkalinjë, duke theksuar nevojën për respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut dhe krijimin e mundësive për punësim.<sup>42</sup> Megjithatë, programi mbetet i paqartë në disa aspekte, siç është specifikimi i ligjeve që do të respektohen dhe masat konkrete për adresimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Pjesa më konkrete e programit përfshin ndërtimin e 400 shtëpive, renovimin e banesave për familjet në nevojë, dhe përmirësimin e infrastrukturës si rrugët, kanalizimet, ndriçimi publik, dhe furnizimi me energji elektrike. Megjithatë, nuk është e qartë kostoja e këtyre masave, vendndodhja specifike e projekteve, si dhe identifikimi i zonave problematike për ndriçimin dhe rrjetin elektrik. Për të qenë më të qarta, masat mund të ishin më të detajuara duke treguar lokalitetet specifike dhe prioritizimin e investimeve.

## 7.8. Demokracia Serbe

Programi i Demokracisë Serbe përqendrohet në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve serbë në Kosovë, duke u angazhuar për lirinë e shprehjes, protestës dhe lëvizjes. Ajo gjithashtu synon të mbështesë kthimin e qëndrueshëm të serbëve, duke kërkuar raporte periodike mbi progresin

42 Programi Politik i PDAK-LPB Uniteti Drejtë Suksesit; PDAK-LPB.

e punës së Ministrisë dhe angazhimin e Bashkimit Evropian për monitorimin e këtij procesi. Një tjetër pikë e rëndësishme është krijimi i mundësive mbështetëse për kthimin e serbëve, por përdorimi i termave si “Kosovë dhe Metohi” është problematik dhe i papranueshëm, pasi përkon me qëndrimet politike të Serbisë dhe bie në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Përdorimi i tillë tregon qëndrim të vazhdueshëm të mohimit të sovranitetit të Kosovës nga ky program politik.

Në lidhje me raportet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, kjo është një iniciativë pozitive që mund të ndihmojë në monitorimin e përpjekjeve për kthimin e qytetarëve serbë, por nuk ka informacion të mjaftueshëm për mënyrën e implementimit të këtyre politikave. Pjesa tjetër e programit duket të jetë pa një plan të qartë dhe veprimtari të strukturuar për realizimin e premtimeve të bëra. Si rezultat, nuk është e qartë se si do të arrihen objektivat e shpallura dhe cilat do të jenë masat konkrete për të mbështetur këtë proces në terren.

Monitorimi i kuotës për të punësuarit serbë në institucionet qendrore është iniciativë e dobishme, por ka një gabim të rëndësishëm në përcaktimin e kuotës nga ky subjekt politik. Ata e kanë vendosur kuotën në 8.5%, ndërkohë që sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë, kuota minimale për përfaqësimin e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera jo shumicë është 10%. Sipas nenit 10 të këtij ligji<sup>43</sup>, kjo kuotë duhet të respektohet për të siguruar përfaqësimin e drejtë të grupeve të pakicës në administratën publike, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, duke reflektuar përqindjen e popullatës përkatëse në çdo komunë.

Një problem tjetër është mungesa e theksit në aspekte të rëndësishme si transparencja në qeverisje, administrata publike dhe barazia gjinore. Këto elemente janë thelbësore për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të qëndrueshme, por Demokracia Serbe duket se i ka lënë jashtë programit të saj. Kjo e bën programin e saj të paplotë dhe tregon se partia nuk ka një vizion të gjërë për zhvillimin e Kosovës si një shtet modern dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

## 7.9. Iniciative e Re Demokratike e Kosovës

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës fokusohet në avancimin e mundësive për arsimim cilësor dhe barazi gjinore, duke u angazhuar për forcimin e pozitës së vajzave dhe grave në komunitet. Përmes arsimimit dhe promovimit të barazisë gjinore, IRDK synon të kontribuojë në parandalimin e braktisjes së shkollës, si dhe të adresojë problemet që lidhen me pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe politikën e dhunës me bazë gjinore. Po ashtu, ky program angazhohet për rritjen e përfaqësimit të grave në politikë dhe përpjekjet për një shoqëri më të barabartë.

Në analizën e programit të IRDK, vërehet se angazhimet për barazi gjinore dhe arsimim nuk janë të detajuara sa duhet. Ndërkohë që premtimet janë të qarta, mungojnë detajet konkrete në lidhje me zbatimin e këtyre masave. Për shembull, nuk jepen detaje mbi masat specifike që do të merren për parandalimin e braktisjes së shkollës fille, as nuk ofrohen të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve që janë jashtë shkollave ose arsytet e prapambetjes në edukim të vajzave. Pa një analizë më të thelluar të këtyre aspekteve, është e vështirë të parashikohet sukses i këtij angazhimi.

<sup>43</sup> Programi parazgjedhor për zgjedhjet parlamentare 2025; Demokracia Serbe; Janar 2025; (Shih linkun: <https://srpskademokratija.org/2025/01/09/predizborni-program-za-parlamentarne-izbore-2025/>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)

Për më tepër, pavarësisht se IRDK premtion të promovojë barazinë gjinore në tregun e punës, programi nuk ofron plan të qartë veprimi, duke lënë të paqartë sesi do të adresohen sfidat që gratë përballen në këtë fushë, siç janë papunësia e lartë dhe mungesa e mundësive të barabarta. Kjo përbën mangësi në programin e tyre, pasi barazia gjinore në punë kërkon një qasje të gjithanshme, përfshirë trajnime, mbështetje për gratë sipërmarrëse, dhe ndryshime në politikën e punës.

Një tjetër mangësi e dukshme është mungesa e detajeve lidhur me luftimin e dhunës me bazë gjinore. Programi nuk tregon sesi do të implementohen masat për këtë qëllim – nëse do të bëhet fjalë për aktivitete avokuese, rritjen e kapaciteteve të institucioneve, apo masa ligjore dhe buxhetore. Po ashtu, një aspekt tjetër që mungon është përfshirja e një plani të detajuar për qeverisjen transparente dhe llogaridhënien, aspekte që janë themelore për një administratë efikase dhe përgjegjëse.

## 7.10. Koalicioni ynë Boshnjak

Programi elektoral i "Koalicionit ynë Boshnjak" fokusohet në ruajtjen dhe promovimin e identitetit të boshnjakëve në Kosovë, duke përfshirë angazhimin për respektimin e gjuhës boshnjake në administratat lokale ku ajo ka status zyrtar, përkthimin e udhëzimeve dhe dokumenteve zyrtare në këtë gjuhë, si dhe forcimin e lidhjeve me Bosnje-Hercegovinën. Programi gjithashtu parashikon mbështetje për traditën, kulturën dhe zakonet boshnjake, si dhe nisma për të përmirësuar jetesën përmes promovimit të turizmit rural, mbështetjes për bizneset lokale dhe përmirësimin të arsimit. Megjithatë, programi mbetet i përgjithshëm dhe mungon detaje të rëndësishme, si përfaqësimi i qartë i popullsisë boshnjake dhe masat konkrete për qeverisje transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Së pari, programi elektoral i Koalicionit tonë Boshnjak është përpjekje e mirë për të adresuar çështjet e identitetit dhe gjuhës së boshnjakëve, duke u fokusuar në të drejtat kulturore dhe gjuhësore. Angazhimi për respektimin e gjuhës boshnjake në administrata dhe përkthimin e dokumenteve zyrtare është një masë e nevojshme për ruajtjen e identitetit kulturor dhe lehtësimin e qasjes në shërbimet publike. Megjithatë, mungesa e të dhënave të sakta për numrin e qytetarëve boshnjakë në komunat e Kosovës tregon një dobësi të programit, pasi këto informacione janë jetike për planifikimin dhe hartimin e politikave të duhura.

Së dyti, programi nuk përmban propozime për reforma më të gjera në administratën publike apo për qeverisje transparente, që janë thelbësore për ndërtimin e një besimi të qëndrueshëm mes komunitetit dhe institucioneve. Nuk ka premtime për emërimin e kandidatëve të ndershëm dhe të pakorrptuar apo për zbatimin e politikave të barazisë gjinore dhe llogaridhënies.

Së fundi, përkundër fokusit në disa fusha të rëndësishme si turizmi dhe arsimit, programi nuk adreson në mënyrë të qartë dhe të matshme rezultatet që synon të arrijë. Publiku dhe shoqëria civile kanë nevojë për plane të strukturuar dhe afate të qarta për implementimin e masave. Për më tepër, mungesa e një qasjeje holistike që përfshin të gjitha aspektet e mirëqenies së komunitetit e bën programin më shumë një përmbledhje të qëllimeve sesa një plan konkret për veprim. Për të fituar më shumë besim dhe mbështetje, Koalicioni duhet të përmirësojë transparencën dhe të ofrojë detaje të matshme dhe konkrete në programin e tij.



## 7.11. Fjala

Partia Fjala, përmes programit të saj elektoral, fokusohet kryesisht në premtimet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e mundësive të punësimit dhe edukimit, si dhe përkujdesjen ndaj grupeve më të cenueshme të shoqërisë. Ajo ka për qëllim të rrisë investimet dhe të sigurojë kushte më të mira për bizneset dhe individët.<sup>44</sup> Megjithatë, nuk ka theks të veçantë në aspekte të tjera të qeverisjes, si menaxhimi transparent i institucioneve shtetërore, administrata publike e pastruar, dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në proceset ligjvënëse.

Partia Fjala, ndonëse e orientuar drejt zhvillimit të sektorëve kyç, përmes programit dështon të japë vizion të qartë për një administratë të pastër dhe të përgjegjshme. Programi i saj elektoral nuk e trajton asnjëherë rëndësinë e krijimit të një strukture qeverisjeje që të mbështetet në transparencë dhe llogaridhënie para qytetarëve. Në vend të kësaj, fjalët e saj përqendrohen vetëm në sfida ekonomike dhe sociale, duke lënë pas dorës përpjekjet për riformatimin e institucioneve shtetërore që mund të kontribuojnë në administratë më efikase dhe të drejtë.

Po ashtu, kritika e dytë që mund të bëhet është mungesa e angazhimit për të inkurajuar një administratë publike të pastër, me duar të pastra. Asnjë nga kapitujt e programit nuk ofron një plan të detajuar për luftën kundër korrupsionit apo për forcimin e mekanizmave që do të sigurojnë zbatimin e ligjit pa preferenca ose ndikime të jashtme.

Në të njëjtën kohë, programi i Partisë Fjala nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme as aspektit të përfshirjes së qytetarëve në ligj bërje. Pa transparencë të duhur dhe pa mundësi që qytetarët të kontribuojnë drejtpërdrejt në proceset vendimmarrëse, është e vështirë të arrihen ndryshime të qëndrueshme dhe përfshirëse.

## 7.12. Partia e Bashkuar e Goranëve

Programi elektoral i Partisë Unike të Gorës paraqet disa prioritete të rëndësishme si transparencë në punësim, promovimi i barazisë gjinore dhe zhvillimi ekonomik, duke theksuar mbështetjen për komunitetin lokal dhe grupet e margjinalizuara. Përfshirja e diskriminimit pozitiv për të rinjtë dhe gratë është element që duhet vlerësuar, pasi kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë sociale. Megjithatë, programi mbetet shumë i përgjithshëm dhe nuk ofron detaje mbi strategjitë dhe politikat konkrete për realizimin e këtyre objektivave, duke e bërë të vështirë vlerësimin e mundësisë për zbatim.

Nga ana tjetër, mungesa e theksimit të çështjeve si qeverisja e mirë, reformat në administratën publike dhe llogaridhënia përbëjnë një mangësi të dukshme në program. Për të fituar besimin e qytetarëve dhe për të përbushur pritshmëritë e tyre, PUG duhet të shtojë elemente konkrete që adresojnë administrimin e përgjegjshëm dhe përfshirjen qytetare në procesin e vendimmarrjes. Një program më i detajuar dhe i balancuar, i cili përfshin mekanizma për zbatimin e premtimeve, do të rriste kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e angazhimeve të partisë.

---

44 Programi Politik i FJAL S – Zgjedhjet 2025; Partia Fjala; Janar 2025; (Shih linkun: <http://www.partiafjala.com/lajme/programi-politik-i-fjal%20s-zgjedhjet-2025-2/>), (Qasur për herë të fundit me 18 janar 2025)

### 7.13. Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë

Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë ka strukturuar një platformë politike me premtime që adresojnë sfida të rëndësishme për shoqërinë kosovare. Megjithëse disa aspekte janë pozitive dhe vënë theksin në fusha kritike si të drejtat dhe liritë individuale, përfshirjen e komuniteteve jo shumicë dhe promovimin e bashkëpunimit, ka mangësi të dukshme në detajimin e politikave dhe masave konkrete që do të përdoren për të arritur këto qëllime.

Vendosja e një kapitulli të veçantë për liritë dhe të drejtat individuale duket të jetë aspekt shumë pozitiv i programit. Kjo tregon edhe përkushtimin e partisë për të siguruar respektimin e të drejtave themelore për çdo qytetar. Megjithatë, programi nuk ofron detaje konkrete për mënyrën se si do të mbrohen dhe promovohen këto të drejta në praktikë. Pa qartësi mbi zbatimin e politikave për mbrojtjen e të drejtave individuale, ky angazhim mbetet më shumë simbolik sesa operacional.

Partia gjithashtu thekson angazhimin për respektimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë dhe ruajtjen e burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore të Kosovës. Qasja e tillë është pozitive, por programi nuk tregon se cilat janë këto burime natyrore dhe trashëgimore apo cilat masa specifike do të merren për mbrojtjen e tyre. Publiku meriton më shumë informacion për të kuptuar rëndësinë dhe mënyrën e zbatimit të këtyre politikave.

Një tjetër pikë që përmendet është mbështetja për institucionet ndërkombëtare dhe vendore që punojnë për të përmirësuar kushtet e komuniteteve jo shumicë. Sidoqoftë, nuk tregohet qartë se cilat politika konkrete do të ndiqen për të garantuar përfshirje të barabartë dhe respektim të të drejtave të tyre. Angazhimi është i rëndësishëm, por mungesa e qartësisë në implementim të programit mund të krijojë paqartësi për qëllimin dhe rezultatet.

Partia përmend sfidat me të cilat përballen përfaqësuesit e komunitetit serb, si mungesa e përfaqësimit të plotë dhe realizimi i të drejtave politike.<sup>45</sup> Ndërsa është pozitive që këto sfida njihen dhe trajtohen, programi nuk jep detaje se si do të realizohet përfaqësimi i plotë apo cilat mekanizma do të përdoren për të garantuar të drejtat politike të këtij komuniteti. Për më tepër, në të gjitha rastet ku përmendet përfaqësimi i komuniteteve jo shumicë, mungojnë detaje specifike mbi mënyrën e krijimit të mekanizmave për përfshirje të qëndrueshme dhe efikase në proceset vendimmarrëse.

Një mungesë e theksuar e programit është mos adresimi i çështjeve të tjera kritike si administrata publike, qeverisja transparente, llogaridhënia, barazia gjinore dhe qeverisja me integritet. Përfshirja e këtyre çështjeve do të ishte qenësore për të krijuar program të plotë dhe gjithëpërfshirës që pasqyron nevojat e qytetarëve të Kosovës dhe standardet moderne të qeverisjes demokratike.

45 *Programi Politik*; Program për Shoqërinë Demokratike të Kosovës; Partia për Lirinë, Drejtësinë dhe Mbijetesë; Janar 2025; (Shih linkun: [https://drive.google.com/file/d/136CJhO2O7y4sBJS9Y\\_6YnnUtyFuZ0kfg/view?fbclid=IwY2xjawlJuhleH-RuA2FlbQlxMQABHfVe6JuYczxan-vUnl4lJfvpqc42UlfYrfX66idnXlHTQcVqS5iVUwPQ9A\\_aem\\_mUgMPf1NVsV6Rn-wWOk00Q](https://drive.google.com/file/d/136CJhO2O7y4sBJS9Y_6YnnUtyFuZ0kfg/view?fbclid=IwY2xjawlJuhleH-RuA2FlbQlxMQABHfVe6JuYczxan-vUnl4lJfvpqc42UlfYrfX66idnXlHTQcVqS5iVUwPQ9A_aem_mUgMPf1NVsV6Rn-wWOk00Q)), (Qasar për herë të fundit me 18 janar 2025).



